

INPO

Iniciativa për progres

ANULIMI I PROKURIMIT

Domosdoshmëri apo keqmenaxhim?

Raport i monitorimit në
njëzet (20) komuna të
Republikës së Kosovës

Autore: Leorenta Alija dhe Albulena Nrecaj

Redaktor: Rexhep Maloku

Ekipi i hulumtuesve: Valmir Ilazi, Ebru Zborça

Të gjitha të drejtat e këtij botimi i takojnë Iniciativës për Progres – INPO. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të printohet, distribuohet, kopjohet, shumëfishohet në çfarëdo forme apo mënyre, elektronike ose të shtypur, pa pajtimin paraprak të Organizatës Iniciativa për Progres. Të drejtat dhe prona intelektuale e këtij botimi mbrohen me Ligjin nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta të Republikës së Kosovës.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Iniciativës për Progres – INPO dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan.

Përkrahur nga:



Përmbajtja

1. Lista e shkurtesave	4
2. Hyrje.....	5
3. Përmbledhje ekzekutive.....	6
4. Metodologjia	7
5. Baza ligjore për anulimin e aktiviteteve të prokurimit.....	9
6. Aktivitetet e anuluar gjatë vitit 2022 në njëzetë (20) komuna	11
6.1.Krahasimi i aktiviteteve të anuluar gjatë viteve 2021 dhe 2022	12
7. Mospublikimi i dokumenteve të domosdoshme gjatë anulimit të aktiviteteve të prokurimit.....	14
7.1.Të dhënat në Formularin B10 - Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, të paplotësuara dhe të pasakta	16
8. Shkaqet më të shpeshta të anulimit të tenderëve sipas zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.....	18
8.1. Efektet negative dhe pasojat e anulimit të aktiviteteve të prokurimit.....	21
9. Analizë aktiviteteve të anuluar në njëzetë (20) komuna	22
9.1. Komuna e Deçanit.....	22
9.2. Komuna e Dragashit.....	22
9.3. Komuna e Ferizajt.....	23
9.4. Komuna e Gillogocit	24
9.5. Komuna e Gjakovës	25
9.6. Komuna e Gjilanit.....	26
9.7. Komuna e Kaçanikut.....	27
9.8. Komuna e Kamenicës	28
9.9. Komuna e Klinës	28
9.10. Komuna e Leposaviqit.....	29
9.11. Komuna e Mitrovicës së Veriut	29
9.12. Komuna e Pejës.....	29
9.13. Komuna e Podujevës	30
9.14. Komuna e Prishtinës	30
9.15. Komuna e Prizrenit.....	32
9.16. Komuna e Rahovecit.....	33
9.17. Komuna e Suharekës	33
9.18. Komuna e Shtimes.....	34
9.19. Komuna e Vitisë.....	35
9.20. Komuna e Vushtrrisë.....	35
10. Komunitat që kanë anuluar aktivitete të prokurimit në mënyrë të kundërligjshme.....	36
11. Gjetjet kryesore.....	38
12. Rekomandime	40
13. ANEKS I - Lista e aktiviteteve të anuluar në njëzetë (20) komuna	42

I. Lista e shkurtesave

AK	Autoritet Kontraktues
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
INPO	Iniciativa për Progres
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LPP	Ligji për Prokurimin Publik
OE	Operator Ekonomik
OShP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
RrPP	Rregulla për Prokurimin Publik
ZPP	Zyrtarë Përgjegjës i Prokurimit

2. Hyrje

Autoritetet Kontraktuese (tutje AK) bazuar në planin e prokurimit, iniciojnë procedurat e prokurimit me qëllim të nënshkrimit të kontratës së furnizimit, shërbimit apo punës së caktuar përmes së cilave përmbushin objektivat institucionale dhe ofrojnë shërbime sipas mandatit të tyre dhe sipas pritshmërisë së qytetarëve. Gjatë udhëheqjes mund të shkaktohen aso rrethanash të cilat mund të çojnë deri te anulimi i aktiviteteve të inicuar.

Korniza ligjore për prokurim publik në Kosovë parasheh mënyrën, procedurat, fazat dhe arsyeshmërinë e anulimit të aktiviteteve të prokurimit. Sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullave të prokurimit vendimi për anulimin e aktiviteteve të prokurimit duhet të jetë plotësisht i justifikueshëm.

Bazuar në monitorimin sistematik të prokurimit publik në komuna, si dhe observimit të përgjithshëm të prokurimit në nivel vendi, INPO ka vërejtur se dukuria e anulimit të tenderëve është duke u rritur, qoftë për nga numri i tenderëve që anulohen apo edhe për nga vlera e parashikuar e tenderëve që anulohen. Bazuar në raportin e punës së Komisionit Rregullativ për Prokurimin Publike (KRPP), gjatë vitit 2022, në të gjitha autoritetet kontraktuese (AK) janë anuluar gjithsej në 2240 aktivitete të prokurimit, apo rreth 30% e tenderëve të inicuar në gjithë vendin. Vetëm 2% e tyre janë anuluar me vendim të Organit Shqyrtues të Prokurimit. Ndërkaq, në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) nga janari deri në shtator 2023 janë parashtruar rreth 165 ankesa kundër njoftimit për anulim.

Për të analizuar shkaqet, arsyet dhe procedurën e anulimit të tenderëve INPO ka hartuar këtë raport të monitorimit duke analizuar aktivitetet e anuluar në njëzet (20) komuna të Kosovës. Ky raport shtjellon aspektet ligjore, teorike dhe praktike të procesit të anulimit të tenderëve duke u fokusuar në justifikimin e vendimeve të anulimit. Në të njëjtën kohë, ky raport ofron të dhëna krahasuese për njëzet (20) komuna, të cilat INPO i ka në fokus të monitorimit.

Raporti është hartuar si pjesë e shqyrtimit të legjislacionit dhe hulumtimeve në terren. Raporti mund të përdoret nga zyrtarët publik, operatorët ekonomikë, shoqëria civile, por mund të përdoret edhe nga akterë të tjerë, përfshirë qytetarët e rëndomtë.

Justifikimi i procedurës së anulimit të tenderëve është elementi kryesor në vlerësimin e ligjshmërisë së këtij procesi, respektivisht anulimit të aktivitetit të prokurimit. Arsyeja për këtë rregull është se operatorët ekonomikë të interesuar të marrin pjesë në procesin e prokurimit investojnë kohë dhe burime në përgatitjen e tenderëve të tyre, të cilat nuk mund të konsiderohen si të papërfillshme. Kësisoj, AK-të rrezikojnë të të jenë subjekt i shqyrtimeve të prokurimit, padive dhe mbi të gjitha cënimit të besueshmërisë së publikut në intergjetin e prokurimit.

Se si kanë përformuar komunat gjatë anulimeve të tenderëve, çfarë justifikime kanë përdorur shpjegohet në këtë raport.

3. Përmbledhje ekzekutive

Gjatë vitit 2022, në komunat e monitoruara janë anuluar njëqind e tridhjetë e katër (134) aktivitete të prokurimit me gjithsej vlerë të parashikuar prej 22,567,215.60 euro. Anulimi i këtyre aktiveve të prokurimit nënkupton se AK-të kanë dështuar që të përmbushin objektivat e tyre institucionale në fushat respektive të cilat kanë qenë lëndë e prokurimit të anuluar, si dhe rrezikojnë që përfundimisht t'i humbin edhe mjetet financiare të dedikuara për ato aktivitete, nëse të njëjtat nuk kanë qenë të financuara direkt nga të hyrat vetanake .

Rezultatet e hulumtimit tregojnë ligjshmërinë e aktiviteteve të anuluar dhe se shumica e komunave të monitoruara nuk publikojnë të gjitha dokumentet e nevojshme lidhur me anulimin e aktivitetit të prokurimit, madje edhe kur ato dokumente publikohen, shpesh ka raste kur të dhënat janë të pasakta dhe kundërthënëse me situatën reale. Reth 70% e komunave, nuk kanë publikuar *Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues*.

Tutje, të gjeturat e INPO-s dëshmojnë se shumica e aktiviteteve anulohen pas hapjes së ofertave, përkatësisht pasi që AK-ja mëson se cilët OE kanë ofertuar. Nga njëqind e tridhjetë e katër (134) aktivitete të anuluar gjatë vitit 2022, njëzetënjë (21) prej tyre, apo 11.42% janë anuluar para hapjes së ofertave, kurse njëqind e trembëdhjetë (113), apo 88.58%, janë anuluar pas hapjes së ofertave. Kjo është një anomali e vazhdueshme e AK-ve e cila duhet të trajtohet me prioritet nga zyrtarët përgjegjës.

Nga njëqind e tridhjetë e katër (134) aktivitete të anuluar gjatë vitit 2022, njëzetënjë (21) prej tyre, apo 11.42% janë anuluar para hapjes së ofertave, kurse njëqind e trembëdhjetë (113), apo 88.58%, janë anuluar pas hapjes së ofertave.

Në shumicën e aktiviteteve të prokurimit të anuluar, justifikimi i vendimeve të anulimit është i paqëndrueshëm dhe nuk përkon me situatën reale se pse një AK e caktuar ka anuluar tenderin. Gabimet në hartimin e paramasës, kërkesave të dosjes dhe dokumenteve të tenderit, mungesa e mjeteve financiare, problemet teknike të paargumentueshme në e-prokurim nuk janë asryse të pranueshme dhe të cilat justifikojnë vendimin për anulim. Sidomos kur këto arsye janë përdorur për të anuluar tenderët pas hapjes së tyre.

Tutje, INPO ka gjetur se një numër i konsiderueshëm i tenderëve të anuluar, qoftë para hapjes apo pas hapjes së tyre, janë tender që nuk është dashur fare të inicohen ose për shkak të kriterëve apo specifikimeve teknike të cilat kanë qenë me element favorizues apo diskriminues ose për shkak të keqpërdorimit të prokurimit, respektivisht tenderëve përmes së cilëve është tentuar të rekrutohet staf për pozitat e rregullta të administratës publike apo staf mjekësor. Një gjetje dhe respektivisht keqpërdorim i prokurimit, i atribuohet komunave të cilat kanë inicuar tender lënda e së cilave ka qenë e rezervuar për kontrata të centralizuara. Rrjedhimisht, këta tenderë është dashur të anulohen.

Përkritazi me gjetjet, INPO ka hartuar rekomandime të përgjithshme dhe konkrete për komunat, zbatimi i së cilave përmirëson integritetin e procesit të anulimit të tenderëve, përmirëson performancën e AK-së në përmbushjen e objektivave institucionale dhe rritë besimin e publik në prokurimin publik.

Rekomandimi kryesor në të cilin INPO insiston është zbatimi i legjislacionit dhe rregullave të prokurimit publik gjatë të gjitha fazave si dhe evitimi i praktikave jo të mira të cilat nuk e justifikojnë anulimin e tenderëve.

4. Metodologjia

INPO, me qëllim që të hartojë një raport përmbajtësor dhe në përputhje me objektivat e projektit, ka përdorur metodologji të kombinuar të hulumtimit. Hulumtimi është i shtrirë në njëzetë (20) Komuna, respektivisht në: Deçan, Dragash, Ferizaj, Glllogoc, Gjakovë, Gjilan, Kaçanik, Kamenicë, Klinë, Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Suharekë, Shtime, Viti dhe Vushtrri. Për qëllime të këtij hulumtimi, aktivitetet e anuluar janë konsideruar aktivitetet të cilat përfundimisht janë anuluar gjatë vitit 2022 dhe nuk është arritur të nënshkruhet kontrata brenda të njëjtin vit fiskal.

Për shkak të situatës në veriun e vendit dhe mungesës së komunikimit me komunën e Leposaviqit dhe Mitrovicës të Veriut, INPO nuk ka mundur që mbledhë të dhënat e hulumtimit në tërësi. Të dhënat e analizës për këto komuna rreth anulimit të tenderëve janë siguruar vetëm përmes platformës së e-prokurimit. Nuk kanë mundur të identifikohen të dhënat për sa i përket numrit dhe kontratave publike të nënshkruara, dhe gjithashtu as ligjshmëria e anulimit të aktiviteteve të prokurimit.

Fillimisht, nëpërmjet kërkesave për qasje në dokumente publike, është kërkuar nga të gjitha komunat e monitoruara të ofrojnë informata rreth numrit të të gjitha aktiviteteve të anuluar gjatë vitit 2022, përfshirë edhe raportin vjetor të kontratave të nënshkruara publike gjatë vitit 2022. Pas kësaj, është analizuar se a përpunet numri i aktiviteteve të anuluar me njoftimet për anulim të aktivitetit të prokurimit të publikuara në platformën e-prokurimi dhe për çdo paqartësi apo dilemë, janë kërkuar informata shtesë nga komunat përkatëse. Tutje, për secilin aktivitet të anuluar është analizuar se a janë publikuar të gjitha dokumentet e nevojshme kur është anuluar një aktivitet i prokurimit, si dhe është vlerësuar saktësia e të dhënave të vendosura në këto dokumente.

Pas grumbullimit dhe vërtetimit të të dhënave lidhur me aktivitetet e anuluar, INPO i ka vendosur këto aktivitete në një listë, duke përshkruar titullin e aktivitetit, numrin e prokurimit dhe vlerën e parashikuar, të cilat janë të bashkangjitura në Aneksin I. Aktivitetet në Aneksin I janë renditur sipas kohës se kur është anuluar aktiviteti i prokurimit dhe për secilën komunë është monitoruar aktiviteti i parë dhe aktiviteti i fundit i anuluar brenda periudhës kohore I janar 2022 deri më 30 prill 2023.¹

Qëllimi i hulumtimit është vlerësimi i ligjshmërisë dhe pasojave të anulimit të aktiviteteve të prokurimit gjatë vitit 2022 në njëzetë (20) komuna të Republikës së Kosovës. INPO ka analizuar përmbajtjen e dokumentacionit të aktiviteteve të anuluar dhe ka vlerësuar nëse anulimet e aktiviteteve të prokurimit janë bërë sipas rregullave dhe procedurave ligjore. Gjithashtu, në këtë

¹ **Shënim:** Periudha e monitorimit përfshinë edhe tre (3) muajt e parë të vitit 2023 për arsye se në këtë periudhë për shkak të afateve ligjore ka rastisur të anulohet përfundimisht aktiviteti i prokurimit. Ndërkaq, të gjitha aktivitetet e anuluar të prokurimit që janë subjekt i këtij raporti i takojnë periudhës raportuese 2022.

raport është bërë krahasimi në mes të aktiviteteve të anuluar gjatë vitit 2021 dhe aktiviteteve të anuluar gjatë vitit 2022.

Me qëllim që hulumtimi të jetë sa më përmbajtësor dhe profesional, INPO përveç konsultave të vazhdueshme me përfaqësues të komunave, përfaqësues të OE-ve dhe akterë tjerë të cilët direkt apo indirekt kanë qenë të lidhur me këtë hulumtim, ka aplikuar edhe një pyetësor me Zyrtarët Përgjegjës të Prokurimit (tutje ZPP) të tetëmbëdhjetë (18) komunave. Pyetësorit nuk i janë përgjigjur vetëm ZPP-të e Dragashit, Suharekës, Vitisë dhe Vushtrrisë. Për shkak të mungesës së zyrtarëve përgjegjës ky pyetësor nuk është zhvilluar në Komunën e Leposaviqit dhe të Mitrovicës së Veriut.

Në fund, drafti i këtij raporti është dërguar tek të gjitha komunat e monitoruara për komente. Komentet e dhëna nga komunat janë pjesë e këtij raporti.

5. Baza ligjore për anulimin e aktiviteteve të prokurimit

Rregullat e prokurimit publik zakonisht lejojnë anulimin e procedurës së prokurimit për arsye të rëndësishme, të paparashikuara, veçanërisht nëse dhënia e kontratës, për shkak të një ndryshimi të papritur të rrethanave, nuk është më në interesin publik. Anulimi i një aktiviteti të prokurimit mund të jetë gjithashtu rezultat i veprimeve të paligjshme të ofertuesve, për shembull nëse rezulton se ata kanë vepruar në bashkëpunim apo kanë krijuar skema të cilat kompromitojnë në tërësi integritetin e procedurës, respektivisht dhënies së kontratës.

Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë (tutje LPP), ka paraparë që aktivitetet e prokurimit të mund të jenë subjekt i anulimit në dy momentume: (i) para hapjes së tenderëve dhe (ii) pas hapjes së tenderëve.² Legjislacioni sekondar parasheh më në detaje arsyet se kur *duhet* dhe kur *mund* të përfundohet apo anulohet një procedurë apo aktivitet i prokurimit. Pra, sipas legjislacionit në fuqi, në disa raste, AK-të e kanë për obligim të anulojnë aktivitetin e prokurimit dhe në disa raste është në diskrecionin e tyre nëse vlerësojnë se duhet bërë një gjë e tillë. Megjithatë, siç u tha më lartë, varësisht nga lloji i kontratës apo procedurës prokurimit, arsyet janë të specifikuar si më poshtë:

- **Para hapjes së ofertave AK-ja duhet ta anulojë aktivitetin për këto arsye:**

- asnjë tenderë nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;
- asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;
- numri i OE-ve të përgjegjshme për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3;
- nuk ka kërkesa për të marrë pjesë në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
- numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/konkurruese me negociata është më pak se 3;
- nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
- asnjë nga projektet e pranuar në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshme;
- nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;
- një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;
- nëse AK-ja, gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes së procedurës, ka përdorur gabimisht opsionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose
- nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK-së dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP-ja.³

² Neni 62, i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092, <https://gzk.rksgov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

³ Neni 43.5, i RrPP, https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legjislacion/Rregulloret/shq/Rregullore%20Nr.001_2022%20p%C3%ABr%20prokurimin%20publik.pdf

- **Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyen se:**
 - të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK-së.⁴

Procedura e prokurimit para hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyet e mëposhtme:

- për shkak të ngjarjeve të demonstrueshme dhe/apo arsyeve që janë jashtë kontrollit të AK-së dhe se nuk ishin të parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por kjo duhet të bëhet së paku tre(3) ditë para hapjes së tenderëve;
- nëse AK-ja gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes së procedurës ka përdorur gabimisht opsionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm;
- është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar, brenda kontrollit dhe domenit të KRPP-së dhe jashtë kontrollit të AK-së dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP-ja;
- nëse është paraqitur pamundësia e përdorimit të platformës elektronike nga të gjithë përdoruesit si pasojë e problemeve teknike jashtë kontrollit dhe domenit të KRPP-së dhe AK-ve dhe verifikimit e konstatimit nga KRPP-ja.⁵

Anulimet e aktiviteteve të prokurimit të cilat bëhen konform ligjit e mbrojnë AK-në nga çfarëdo përgjegjësie ligjore, përkatësisht nga pretendimet që mund të kenë OE-të, sidomos në procese të shqyrtimit të prokurimit në OShP, apo në rrugë gjyqësore lidhur me shkaktimin e dëmit dhe kërkesat për kompensim si pasojë e anulimit të aktivitetit të prokurimit.⁶

Rrjedhimisht, nëse AK-ja anulon aktivitetin e prokurimit në kundërshtim me dispozitat ligjore, përkatësisht për arsye të cilat nuk janë të përmendura në ligj dhe të cilat nuk janë të bazuara në arsye objektive të cilat janë lehtësisht të verifikueshme, atëherë AK-ja mund të përballet me procese administrative dhe gjyqësore që kanë të bëjnë me shkelje të dispozitave ligjore të prokurimit, keqpërdorim të detyrës zyrtare, prishje të reputacionit të AK-së si dhe humbje të besimit të publikut në AK.

⁴ Neni 43.7 , i RrPP, https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/Rregullore%20Nr.001_2022%20p%C3%ABr%20prokurimin%20publik.pdf

⁵ Po aty, neni 43.8.

⁶ Po aty, neni 43.9.

6. Aktivitetet e anuluar gjatë vitit 2022 në njëzetë (20) komuna

Në vitin 2022, në njëzet (20) komunat e fokusit janë anuluar saktësisht njëqind e tridhjetë e katër (134) aktivitete të prokurimit. Komuna e Prishtinës prin me numrin më të madh të aktiviteteve të anuluar, respektivisht me njëzet e tre (23), pasuar nga Komuna e Gjakovës me katërmëdhjetë (14) anulime dhe Komuna e Prizrenit me tremëdhjetë (13) aktivitete të anuluar.

Krahasuar me numrin e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2022 dhe numrin e aktiviteteve të anuluar gjatë vitit 2022, listën e kryeson Komuna e Gjakovës me 12.39% të aktiviteteve të anuluar, e pasuar nga Komuna e Gjilanit me 10.1%, duke vazhduar tutje me Komunën e Prishtinës me 9.7%.

Në tabelën më poshtë është analizuar edhe vlera e parashikuar e aktiviteteve të anuluar gjatë vitit 2022. Pastaj këto të dhëna janë krahasuar me vlerën totale të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2022 nga secila komunë. Të dhënat tregojnë se krahasuar me vitin paraprak, në vitin 2022 vlera e kontratave të nënshkruara është pothuajse e njëjtë me atë të vitit të kaluar. Komuna e cila ka numrin më të lartë të kontratave publike të nënshkruara gjatë vitit 2022, padyshim që është ajo e Prishtinës, pasuar nga Komuna e Prizrenit dhe e Rahovecit. Ndërsa, të gjeturat e hulumtimit tregojnë se vlera e parashikuar e aktiviteteve të anuluar nga Komuna e Suharekës është e barabartë me 73.28% të vlerës totale të kontratave të nënshkruara, pasuar nga Komuna e Gjakovës me 51.63%, Komuna e Gjilanit 36.68%, e të tjera me radhë.

Komuna e Deçanit është komunë e cila për të dytin vit me radhë nuk ka aktivitete të anuluar. Aktivitetet të cilat janë anuluar nga kjo komunë, pas ritenderimit të aktivitetit ka arritur t'i nënshkruajë kontratat.

Aktivitetet e anuluar gjatë vitit 2022 në njëzetë (20) komuna ⁷						
Komuna	Anulimet në numra			Anulimet në vlerë		
	Numri i kontratave 2022	Numri i anulimeve 2022	Përqindja	Vlera e kontratave 2022 €	Vlera e aktiviteteve të anuluar 2022 €	Përqindja
Deçan	33	N/A	0.00	9,598,165.28	N/A	0.00%
Dragash	195	3	1.54%	4,739,551.18	32,980.64	0.69%
Ferizaj	106	10	9.43%	9,918,123.89	539,100.00	5.43%
Glllogoc	101	7	6.93%	8,367,302.19	411,473.57	4.91%
Gjakovë	113	14	12.39%	4,892,108.27	2,525,805.88	51.63%
Gjilan	99	9	8.91%	3,154,649.19	1,157,166.00	36.68%
Kaçanik	101	4	3.96%	3,812,758.40	365,650.00	9.59%
Kamenicë	93	2	2.15%	4,583,579.90	12,769.00	0.27%
Klinë	118	8	6.78%	3,363,490.76	359,264.00	10.68%
Leposaviq	N/A	5	N/A	N/A	93,995.00	N/A
Mitrovicë e Veriut	N/A	1	N/A	N/A	2,000.00	N/A

⁷ **Burimi:** Raportet vjetore të kontratave publike të nënshkruara për vitin 2022, platforma e-prokurimi dhe nëpërmjet kërkesave për qasje në dokumente publike.

Pejë	110	2	1.82%	9,081,839.44	120,000.00	1.32%
Podujevë	158	4	2.53%	11,076,222.19	305,944.40	2.76%
Prishtinë	237	23	9.7%	19,148,706.84	5,761,500.00	30.08%
Prizren	237	13	5.49%	17,566,532.48	3,637,050.00	20.70%
Rahovec	91	4	4.4%	12,894,227.57	366,481.07	2.84%
Suharekë	161	10	6.21%	8,498,400.87	6,228,048.39	73.28%
Shtime	107	2	1.87%	3,692,715.16	9,000.00	0.24%
Viti	63	5	7.94%	11,701,769.35	371,826.25	3.17%
Vushtrri	183	7	3.83%	3,841,629.39	389,161.40	10.13%
Gjithsej	2306	134	5.81%	138,230,003.00	22,567,215.60	16.32%

Tabela I: Aktivitetet e anuluar gjatë vitit 2022 në njëzetë (20) komuna.

6.1. Krahasimi i aktiviteve të anuluar gjatë viteve 2021 dhe 2022

INPO ka krahasuar numrin e aktiviteve të anuluar gjatë viteve 2021 dhe 2022, të dhënat në tabelën më poshtë tregojnë se kemi një rënie të lehtë të aktiviteve të anuluar, ku nga njëqind e katërdhjetë (140) aktivitete sa ishin anuluar gjatë vitit 2021, ky numër gjatë vitit 2022 është ulur vetëm për gjashtë (6) sosh, më saktësisht në njëqind e tridhjetë e katër (134) aktivitete të anuluar, pra kemi një rënie prej 5.81%. Përkundër rënies së aktiviteve të prokurimit në numër, INPO vëren se vlera e parashikuar e aktiviteve të anuluar është më e madhe se vitin e kaluar. Në vitin 2021 vlera e përbashkët e tenderëve të anuluar ishte 21,285,876.06€, ndërsa më 2022 vlera e përgjithshme e tyre është 22,567,215.60€, apo mbi 16% më e lartë se e vitit paraprak.


Krahasimi i aktiviteve të anuluar gjatë viteve 2021 ⁸ dhe 2022						
Komuna	Aktivitetet e anuluar gjatë vitit 2021		Aktivitetet e anuluar gjatë vitit 2022		Krahasimi 2022	
	Numri	Vlera €	Numri	Vlera €	Numri	Vlera €
Prishtinë	12	2,870,852.00	23	5,761,500.00	+11	+2,890,648.00
Gjakovë	8	1,110,462.40	14	2,525,805.88	+6	+1,415,343.48
Klinë	2	114,600.00	8	359,264.00	+6	+244,664.00
Leposaviq	1	32,000.00	5	93,995.00	+4	+61,995.00
Gjilan	7	2,716,374.76	10	1,157,166.00	+3	-1,559,208.00
Viti	3	551,790.15	5	371,826.25	+2	-179,963.90
Kaçanik	2	35,000.00	4	365,650.00	+2	+330,650.00
Shtime	0	0	2	9,000.00	+2	+9,000.00
Pejë	3	131,669.00	2	120,000.00	+1	-11,669.00
Prizren	20	2,846,883.10	13	3,637,050.00	-7	+790,166.90
Glllogoc	13	737,610.55	7	411,473.57	-6	-326,136.98
Ferizaj	16	4,244,750.00	10	539,100.00	-6	-3,705,650.00
Suharekë	16	1,231,196.00	10	6,228,048.39	-6	+4,996,852.39
Mitrovicë e Veriut	6	166,490.00	1	2,000.00	-5	-164,490.00
Kamenicë	6	144,850.00	2	12,769.00	-4	-132,081.00
Vushtrri	12	331,356.58	7	389,161.40	-4	+57,804.82
Dragash	5	50,582.00	3	32,980.64	-2	-17,601.36
Podujevë	4	214,899.4	4	305,944.40	=	+91,045.00

⁸ **Burimi:** Raporti "Ligjshmëria dhe transparenca e tenderëve të anuluar", <http://inpo-ks.org/ep-content/uploads/2022/07/Ligjshm%C3%ABria-dhe-transparenca-n%C3%AB-anulimin-e-tender%C3%ABve-.pdf> dhe hulumtimi i aktiviteve të anuluar gjatë vitit 2022.

Rahovec	4	3,754,510.12	4	366,481.07	=	-3,388,029.05
Deçan	0	0	0	0	0	0
Gjithsej	140	21,285,876.06	134	22,567,215.60	-3	+1,281,339.54

Tabela 2: Krahasimi i aktiviteteve të anuluar gjatë viteve 2021 dhe 2022.

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën më lartë, vërejmë se Komuna e Prishtinës është komuna me më së shumti aktivitete të anuluar, me njëzet e tre (23) sosh, pasuar nga komuna e Gjakovës me katërbëdhjetë (14), ajo e Prizrenit me trembëdhjetë (13), Ferizaj, Gjilan dhe Suharekë me nga dhjetë (10) aktivitete të anuluar.



Grafika I: Krahasimi i aktiviteteve të anuluar gjatë viteve 2021 dhe 2022 në 6 komunitat

Krahasuar me vitin pararak, INPO vëren se Komuna e Prishtinës ka rritur numrin e aktiviteteve të anuluar në vitin 2022, nga dymbëdhjetë (12) aktivitete të anuluar sa kishte, në njëzet e tre (23), pasuar nga Komuna e Gjakovës nga tetë (8) sa kishte gjithsej në vitin 2021 në katërbëdhjetë (14) gjatë vitit 2022 dhe Komuna e Klinës nga dy (2) sa kishte në vitin 2021, në tetë (8) në vitin 2022. Komuna e Vitisë ka një rritje aktiviteteve të anuluar nga tre (3) sa kishte në vitin e kaluar, në pesë (5) sosh dhe komuna Kaçanikut nga dy (2) sa kishte gjatë vitit 2021, në katër (4) në vitin 2022.

Ndërsa, në komunat në të cilat ka rënie të aktiviteteve të anuluar janë Komuna e Glllogocit e cila nga trembëdhjetë (13) aktivitete të anuluar, ka rënë në tetë (8) gjatë vitit 2022, pasuar nga Komuna e Ferizajt nga gjashtëmbëdhjetë (16) aktivitete, në dhjetë (10) gjatë vitit 2022 dhe Komuna e Vushtrrisë nga dymbëdhjetë (12) aktivitete të anuluar, në tetë (8).

Komuna e Shtimes, për dallim nga viti i kaluar kur nuk ka pasur aktivitete të anuluar, përkundër ritenderimeve nuk ka arritur të hyjë në obligime kontraktuale, andaj si rezultat i kësaj bën pjesë në mesin e komunave ku ka ngritje të aktiviteteve të anuluar me dy (2) të tilla.

7. Mospublikimi i dokumenteve të domosdoshme gjatë anulimit të aktiviteteve të prokurimit

Vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, është një hap procedural i cili përveç që nënkupton se AK-ja e ndërpre procedurën lidhur me atë aktivitet të prokurimit, në të njëjtën kohë nënkuptohet dhe është ligjërshëm nxjerrja e disa dokumenteve.

Dokumenti i parë i cili kërkohet menjëherë pas vendimit për anulim të aktivitetit të prokurimit është Formulari B58, apo Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku duhet të paraqitet në mënyrë të detajuar baza ligjore dhe të gjitha shkaqet dhe arsyet që kanë shtyrë AK-në të bëjë anulimin të aktivitetit të prokurimit.⁹ Nëse palët në procedurë nuk parashetrojnë kërkesa për rishqyrtim, apo kërkesat në fjalë nuk janë të suksesshme, AK-ja pas skadimit të afatit kohor për parashtrim dhe shqyrtim të ankesave, do të përgatitë Formularin B10 Njoftimi për Anulim të aktivitetit të prokurimit, pavarësisht nga lloji apo vlera e parashikuar dhe njoftimin e tille do ta publikojë në platformën e prokurimit elektronik.¹⁰

INPO gjatë monitorimit ka identifikuar rastet kur komunat nuk e kanë publikuar Formularin B58, në platformën E-prokurimi, respektivisht Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Të dhënat se në cilat komuna ka munguar ky dokument i obligueshëm ligjor, i gjeni në tabelën në vazhdim.

Aktivitetet e anuluar me mungesë të dokumenteve të domosdoshme ¹¹				
Komuna	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Formulari B58	Formulari B10
Ferizaj	Furnizim me material shpenzues të stomatologjisë për nevojat e QKMF-së	656-22-290-1-2-1	-	+
	Mbushja e bocave me oksigjen medicinal dhe furnizimi me manometra për boca të oksigjenit për nevoja të QKMF-së Ferizaj	656-22-355-1-3-6	-	+
	Funksionalizimi i deponive të ngurta	656-22-1013-5-2-1	-	+
	Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative	656-22-13923-5-5-8	-	+
	Furnizimi i fermerëve me koshere të bletëve	656-22-1926-1-2-1	-	+
Glllogoc	Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i objekteve shëndetësore	611-22-6570-2-2-1	-	+

⁹ Për më shumë shih nenin 43.1 i RrPP, i qashshëm në https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/Rregullore%20Nr.001_2022%20p%C3%ABr%20prokurimin%20publik.pdf.

¹⁰ Për më shumë shih nenin 43.2 i RrPP, i qashshëm në https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/Rregullore%20Nr.001_2022%20p%C3%ABr%20prokurimin%20publik.pdf.

¹¹ **Burimi:** Platforma elektronike e-prokurimi, <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNeë.aspx>.

	Rregullimi dhe mirëmbajtja e trotuarëve dhe parkingjeve - faza e dyte	611-22-9732-5-3-6	-	+
	Furnizim me veshmbathje për nevojat e punëtorëve të komunës	611-22-12284-1-3-6	-	+
	Sigurime aksidentale për nxënësit në ShMO "Fehmi Lladrovci", Drenas	611-22-12776-2-2-1	-	+
	Ndërtimi i kapaciteti të ujësjellsit - Projekt dy vjeçar	611-22-12335-5-2-1	-	+
Gjakovë	Akordimi i veglave muzikore në shkollën Prenk Jakova	632-22-10811-2-3-6	-	+
	Inspektimi i kërkesave themelore për shëndet dhe siguri për ndërtimet pa leje-për ndërtimet në kategorinë II-të(jo shtëpitë)	632-22-6221-2-2-1	-	+
	Shërbime të telefonisë mobile - Kontratë tre vjeçare	632-22-2113-2-2-1	-	+
	Furnizimi me aparate mjekësore dhe jomjekësore	632-22-6415-1-2-1	-	+
	Rregullimi i shtratit të Lumit Krena	632-22-7920-5-1-1	-	+
Kaçanik	Shërbime kontraktuale - Specialist i Gjinekologjisë.	652-22-5100-2-2-1	-	+
	Ndërtimi i rrjeteve të ujësjellsve- faza e parë	652-22-2182-5-3-6	-	+
Kamenicë	Marrëveshje kornizë - Furnizim me pemë dhe perime	KM653-22-11191-5-5-8	-	+
	Furnizim me kamera dhe pajisje tjera për teknologji informative	KM653-22-11997-1-3-6	-	+
Klinë	Furnizim me shujta ditore per nxënës	634-22-369-1-2-1	-	+
	Shërbime të telefonisë mobile për nevoja të administratës komunale	634-22-76-2-2-4	-	+
	Furnizim me oksigjen O2 per nevoja të QKMF-së Nënë Tereza Klinë	634-22-940-1-3-6	-	+
	Furnizim me material per praktike profesionale	634-22-8126-1-2-1	-	+
	Hartim i projekteve zbatuese	634-22-79-2-2-1	-	+
Pejë	Mirëmbajtja verore e rrugëve LOT 1 Mirëmbajtja verore e rrugëve në qytetin e Pejës LOT 2 Mirëmbajtja verore e	635-22-8396-2-1-1	-	+
Podujevë	Servisimi i automjeteve të institucioneve komunale	615-22-7089-2-2-1	-	+
Prishtinë	Furnizim me material shpenzues administrativ për nevojat e Komunës së Prishtinës	616-22-3601-1-2-1	-	+
	Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor	616-22-5534-2-1-1	-	+
	Furnizim me uniforma	616-22-6323-1-2-1	-	+
	Furnizim me tabela të mençura për institucionet arsimore	616-22-8816-1-1-1	-	+
Prizren	Furnizim me libra sanitare për stafin e kujdesit parësor në Komunën e Prizrenit	622-22-8485-1-2-1	-	+
	Ofrimi i shërbimeve konsulente nëpërmjet marrveshjeve për shërbime të veçanta (konsulent individë) për nevojat e njësisë së auditimit të brendshëm në Komunën e Prizrenit 2 LOTE PJESË	622-22-9819-2-3-6	-	+

Rahovec	Mirëmbajtja e ngrohjeve qendrore në shkollat e Komunës së Rahovecit	623-21-5374-2-2-1	-	+
Suharekë	Mirëmbajtja e e-kioskave	624-22-10862-2-3-6	-	+
	Shërbimet e Energjisë sipas Udhëzimit Administrativ Shërbimet e Energjisë (ESCO)	624-22-12988-2-1-1	-	+
	Shërbimet e transportit të nxënësve për vitin 2023-2024 7 lot	624-22-14617-2-1-1	-	+
Viti	Mirëmbajtja e e-kioskut në Pozheran	657-22-3508-2-3-6	-	+
Vushtrri	Furnizim me paisje për lavanteri	644-22-6272-1-3-6	-	+

Tabela 3: Aktivitetet e anuluar me mungesë të dokumenteve të domosdoshme.

Nga të dhënat në tabelën më lart, vërtetohet se komunat nuk respektojnë dispozitat ligjore të cilat përcaktojnë qartë se cila dokumente duhet të publikohen në momentin kur anulohet një aktiviteti i prokurimit, përkatësisht nga tetëmbëdhjetë (18) komunat e monitoruara, katërmëdhjetë (14) prej tyre ka raste kur nuk kanë publikuar Formularin B58 - Njoftimin mbi Vendimin e AK-së për aktivitetet e anuluar.

Saktësisht, Komuna e Ferizajt, Glllogocit, Gjakovës dhe Klinës për pesë (5) aktivitete nuk e kanë publikuar në platformën eprokurimi Formularin B58. Komuna e Prishtinës për katër (4) aktivitetet e anuluar nuk e ka publikuar Formularin B58. Ndërsa, Komuna e Suharekës për tre (3) aktivitete të anuluar nuk e ka publikuar Formularin ashtu siç e kërkojnë dispozitat ligjore, tutje Komuna e Kaçanikut, Kamenicës dhe Prizrenit për dy (2) aktivitete të anuluar nuk kanë publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-s për këto aktivitete. Me nga një (1) aktivitet për të cilin nuk e kanë publikuar formularin B58 janë Komuna e Pejës, Podujevës, Rahovecit, Vitisë dhe Vushtrrisë.

Mospublikimi i këtyre dokumenteve përveç që është shkelje ligjore, në të njëjtën kohë kufizon të drejtën e OE-ve pjesëmarrëse në procedurë që të dinë arsyet e sakta të anulimit të aktivitetit të prokurimit dhe pastaj eventualisht ato arsye t'i kundërshtojnë me kërkesë për rishqyrtim apo ankesë. Gjithashtu, mospublikimi i Formularit B58 është ikje nga përgjegjësia e ZPP-ve, sepse ky dokument pasi të shpjegojë arsyet e anulimit të aktivitetit të prokurimit kërkon edhe nënshkrimin e ZPP-së.¹² Pra në rrethana të tilla vihet në dyshim edhe profesionalizmi dhe arsyeshmëria e anulimit të aktivitetit të prokurimit.

7.1. Të dhënat në Formularin B10 - Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, të paplotësuar dhe të pasakta

Formulari B10 - Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, nënkupton se AK-ja përfundimisht ka vendosur ta anulojë aktivitetin e prokurimit. Ky formular është formular standard i hartuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (tutje KRPP) dhe brenda tij duhet të plotësohen të dhënat relevante.¹³

¹² Për më shumë shih legjislacionin sekondar të aprovuar nga KRPP, Formulari B58, <https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=233>.

¹³ Për më shumë, shih legjislacionin sekondar të aprovuar nga KRPP, Formulari B10, <https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=233>.

Përveç të dhënave që e identifikojnë AK-në, titullin e aktivitetit, vlerën e parashikuar, procedurën e ndjekur, e kështu me radhë, ndër të dhënat shumë të rëndësishme që duhet të vendosen në këtë formularë janë: Informata se AK-ja e bënë anulimin e aktivitetit të prokurimit para apo pas hapjes së ofertave, arsyet e anulimit dhe informatat shtesë, ku zakonisht shkruhen detaje lidhur me arsyet e anulimit.

INPO ka evidentuar raste kur të dhënat e paraqitura në njoftimin mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit nuk kanë qenë të sakta.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur dallimet ndërmjet asaj se çfarë është paraqitur në Formularin B10 lidhur me atë se aktiviteti është anuluar para apo pas hapjes së ofertave dhe si ka rezultuar pas verifikimit të të dhënave në formular nga monitoruesit e INPO-s. Në tabelë janë të paraqitura vetëm komunat në të cilat ka pasur informata të pasakta.

Faza e anulimit të aktiviteteve, kundërthëniet në mes të dhënave në Formularin B10 dhe të dhënave reale pas monitorimit¹⁴						
Komuna	Numri i aktiviteteve të anuluar	Faza e anulimit të aktivitetit				
		Formulari B10			Të dhënat pas verifikimit	
		Para hapjes	Pas hapjes	Nuk është saktësuar në B10	Para hapjes	Pas hapjes
Dragash	3	0	3	N/A	0	3
Ferizaj	10	2	8	N/A	2	8
Gllgoc	7	1	6	N/A	2	5
Gjakovë	14	4	10	N/A	2	12
Gjilan	10	2	8	N/A	2	8
Kaçanik	4	0	4	N/A	0	4
Kamenicë	2	0	2	N/A	0	2
Klinë	8	1	4	3	1	7
Leposaviq	5	2	3	N/A	2	3
Mitrovicë e Veriut	1	0	N/A	1	0	1
Pejë	2	0	2	N/A	0	2
Podujevë	4	1	3	N/A	1	3
Prishtinë	23	8	15	N/A	4	19
Prizren	13	1	11	1	0	13
Rahovecë	4	1	3	N/A	1	3
Suharekë	10	3	7	N/A	3	7
Shtime	2	0	2	N/A	0	2
Viti	5	4	1	N/A	1	4
Vushtrri	7	1	6	N/A	0	7
Gjithsej	134	31	98	5	21	113

Tabela 4: Faza e anulimit të aktiviteteve, kundërthëniet në mes të dhënave në Formularin B10 dhe të dhënave reale pas monitorimit.

¹⁴ **Burimi:** Analizimi dhe krahasimi i Formularit B10 dhe krahasimi me Formularin B58 - Njoftimi mbi vendimin e AK-së.

Të dhënat në tabelë dëshmojnë se sipas të dhënave të Formularit B10 nga njëqind e tridhjetë e katër (134) aktivitete të anuluar gjatë vitit 2022, tridhjet e një (31) prej tyre janë anuluar para hapjes së ofertave, kurse nëntëdhjetë e tetë (98), janë anuluar pas hapjes së ofertave, ndërsa në pesë (5) aktivitete të anuluar kjo e dhënë ka munguar në Formularin B10.

INPO ka analizuar të gjitha këto aktivitete dhe ka evidentuar raste kur kjo e dhënë është paraqitur gabimisht, ose në disa raste nuk është paraqitur fare. Të gjeturat tregojnë se aktivitetet e anuluar para hapjes janë njëzet e një (21) aktivitete, ndërsa pas hapjes së tenderëve janë anuluar njëqind e trembëdhjetë (113) aktivitete. Sikur se vërehet edhe në tabelë komunat që kanë ofruar të dhëna të pasakta në Formularët B10 janë: Komuna e Gllgocit, Gjakovës, Klinës, Prishtinës, Prizrenit dhe Komuna e Vushtrrisë.

Këto të dhëna të pasakta dhe kundërthënëse të paraqitura nga AK-të, përveç që tregojnë joprofesionalizëm të zyrtarëve që kanë për autorizim zhvillimin e procedurave të prokurimit, në të njëjtën kohë krijojnë pasqyrë të pasaktë për publikun dhe lënë hapësirë për të ngritur dyshime rreth integritetit të procedurës së anulimit të tenderit.

8. Shkaqet më të shpeshta të anulimit të tenderëve sipas zyrtarëve përgjegjës të prokurimit

Në kuadër të hulumtimit të aktiviteteve të anuluar, INPO ka realizuar edhe një pyetësor jo të standardizuar, me pyetje të hapura, me zyrtarët përgjegjës të prokurimit të komunave të fokusit rreth shkaqeve më të shpeshta të cilat ndikojnë që të bëhet anulimi i tenderëve. Pyetjeve nuk u janë përgjigjur ZPP-të e komunave të Dragashit, Suharekës, Vitisë dhe Vushtrrisë. Ndërsa, pyetësi nuk është përcjellë fare tek Komuna e Leposaviqit dhe Komuna e Mitrovicës së Veriut për shkak të mungesës së kontaktit me zyrtarët përgjegjës brenda këtyre insitucioneve gjatë periudhës së hulumtimit.

Pyetësor me zyrtarët përgjegjës të prokurimit ¹⁵			
Komuna	Cilat janë arsyet më të shpeshta për anulimin e aktiviteteve të prokurimit?	Pse në formularin B10-Njoftimi mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit, ka raste kur mungojnë arsyet e anulimit?	A ka ndikuar rritja e çmimeve të tregut në anulimin e aktiviteteve të prokurimit? Nëse po, sa është numri i aktiviteteve të anuluar për këtë arsye?
Deçan	Mungesa e buxhetit të planifikuar.	PO (Tejkalimi i buxhetit të planifikuar).	PO, kemi dy (2) aktiviteteve të prokurimit të anuluar dhe të rishpallura: 1.Furnizim me dru për nxemje dhe 2.Furnizim me teknologji informative(paisje elektronike).
Dragash	ZPP nuk i është përgjigjur pyetësorit.	ZPP nuk i është përgjigjur pyetësorit.	ZPP nuk i është përgjigjur pyetësorit.

¹⁵ **Burimi:** Pyetësor i realizuar me zyrtarët përgjegjës të prokurimit.


Ferizaj	Tejkalimi i vlerës së parashikuar, asnjë ofertë e përgjegjshme dhe kur nuk kemi asnjë ofertues.	Mund të ketë ndonjë rast mirëpo, arsyet gjithësesi janë të cekura në vendimin e AK-së.	Dy nga anulimet që kemi bërë kanë qenë raste ku OE-të kanë refuzuar nënshkrimin e kontratës me arsye të rritjes së çmimeve.
Glllogoc	Gabime teknike në paramasë dhe Ofertat mbi vlerën e parashikuar.	Ne e cekim vetëm bazën ligjore dhe me B58 tregojmë arsyet për anulim.	Jo.
Gjakovë	Mungesa e mjeteve buxhetore.	Ka arsyeje të ndryshme.	PO. p.sh Furnizim me pelet - - Furnizim me Dru
Gjilan	Nuk është përgjigjur në këtë pyetje.	Mendoj se arsyetimet e anulimit janë në Njoftimin e AK.	Po.
Kaçanik	Niuk kemi pasur oferta të përgjegjshme	Nuk ka raste të tilla.	Në shumicën e rasteve jo
Kamenicë	Mungesë e ofertave të përgjegjshme ose mospjesëmarrje fare në aktivitetin e zhvilluar të prokurimit.	Të gjitha të dhënat e anulimit figurojnë tek vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit.	3.
Klinë	Mungesë e ofertave si dhe ofertave të përgjegjshme	Në shumicën e rasteve janë detajisht të cekura, por ka raste kur mund të më ikë.	Po 13 kanë qenë në mungesë të ofertave dhe 10 për arsye të tejkalimit të planifikimit
Leposaviq	Nuk është zhvilluar intervistë në këtë komunë.	Nuk është zhvilluar intervistë në këtë komunë.	Nuk është zhvilluar intervistë në këtë komunë.
Mitrovicë e Veriut	Nuk është zhvilluar intervistë në këtë komunë.	Nuk është zhvilluar intervistë në këtë komunë.	Nuk është zhvilluar intervistë në këtë komunë.
Pejë	Mosofertimi i operatorëve	Në AK-në tonë nuk kemi raste të tilla.	Kemi nderpre disa kontrata si rezultat i ngritjes së çmimeve
Podujevë	- Nuk ka ofertuar asnjë OE; - Nuk ka patur ofertues të përgjegjshëm - Çmimi i ofertuesve shumë i lartë mbi vlerën e parashikuar dhe për AK i paperballueshëm; dhe - Gabime në pozicionin e OE.	Vetëm në rast se kur nuk ka asnjë operator ofertues, atëherë mungon një arsyetim i veçantë.	Po ka ndikuar shumë në saje të rritjes së çmimeve në treg, andaj për shkak të mospërballimit të çmimeve të tejkalimit të vlerës së parashikuar, planifikuar nga OE mbi 30% e më shumë, kemi pasë 3(tri) anulime të procedurave.
Prishtinë	Mungesa e operatorëve të përgjegjshëm.	Në Komunën e Prishtinës në Njoftimin për anulim të aktivitetit çdo herë jepen arsyet e anulimit.	Për shkak të ngritjes së çmimeve janë shkëputur 30 kontrata të nënshkruara në vitin 2021
Prizren	Arsyet më të shpeshta të anulimit janë: 1. Nuk ka asnjë OE të përgjegjshëm në procesin e vlerësimit dhe 2. Nuk ka asnjë ofertues në proceset e prokurimit.	Në të gjithë formularët B10 Komuna e Prizrenit jep ndoshta në pika të shkurta (por gjithësesi nuk mungojnë) arsyet e anulimit të secilit aktivitet të prokurimit.	Rritja e çmimeve të tregut më tepër ka ndikuar në anulimin e kontratave të nënshkruara, e në anulim të proceseve nuk ka ndikuar shumë, sepse në parashikim të vlerave të kontratës janë kalkuluar çmimet e rritura për atë periudhë.
Rahovec	Asnjë ofertë e dorëzuar nuk është e përgjegjshme; Asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar.	Çdo herë Arsyet për anulim janë tek: V.2) INFORMACIONET SHITESË - Në formular B10	4. N/A

Suharekë	ZPP nuk i është përgjigjur pytësorit.	ZPP nuk i është përgjigjur pytësorit.	ZPP nuk i është përgjigjur pytësorit.
Shtime	Tejkalimi i vlerës së parashikuar, mosplotësimi i kriterëve nga ana e OE , mospjesëmarrja në aktivitete të prokurimit nga ana e OE	Në AK ku unë punoj, çdo herë e cek aryetimin.	Po, rritja e çmimeve ka ndikuar në anulimin e aktiviteteve, kjo është arsyeja që OE e tejkalojnë vlerën e parashikuar të kontratës.
Viti	ZPP nuk i është përgjigjur pytësorit.	ZPP nuk i është përgjigjur pytësorit.	ZPP nuk i është përgjigjur pytësorit.
Vushtrri	ZPP nuk i është përgjigjur pytësorit.	ZPP nuk i është përgjigjur pytësorit.	ZPP nuk i është përgjigjur pytësorit.

Tabela 5: Përgjigjet e pytësorit nga zyrtarët përgjegjës të prokurimit.

Siç mund të vëreni në tabelën 5, arsyet më të shpeshta të anulimit të tenderëve kryesisht ndërlidhen me rastet kur asnjë OE nuk ka ofertuar në një aktivitet të caktuar apo edhe raste kur edhe OE-të të cilët kanë ofertuar, rezultojnë të jenë të papërgjegjshëm. Nuk anashkalohen edhe rastet kur ofertat anulohen me kërkesë të njësisë së kërkesës për shkak të gabimeve në paramasë, apo edhe rastet tjera kur të gjitha ofertat e paraqitura tejkalojnë vlerën e parashikuar për një aktivitet, e që kjo del të jetë jashtë parashikimeve buxhetore për një AK. Ndërkaq, asnjëherë nuk janë përmendur si arsye vendimet e OSHp-së për anulimin e tenderëve.

Duke u bazuar në gjetjet e hulumtimit, del se anulimi i tenderëve kryesisht ndodhë për shkak të mungesës së ofertuesve apo të së paku një ofertuesi të përgjegjshëm, INPO ka testuar nëse kriteret e dosjes së tenderit mund të ndikojnë në kufizimin e numrit të ofertave, respektivisht ofertuesve. Kësisoj INPO ka realizuar pyetësor vetëm me një (1) pyetje të mbyllur në komuna.



Në pyetjen “A konsideroni se kriteret e paraqitura në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë ndikojnë që të anulohen aktivitetet e prokurimit për shkak të mosofertimit të asnjë operatori ekonomik?” 72% e ZPP-ve respondent mendojnë se kriteret e paraqitura në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë nuk ndikojnë në anulimin e aktiviteteve të prokurimit.

Vetëm 14% e ZPP-ve potencojnë se kriteret e paraqitura në dosjen e tenderit ndikojnë që të anulohen aktivitetet e prokurimit për shkak të mosofertimit të asnjë operatori ekonomik, 7% mendojnë se mund të jenë dhe 7% të tjerë nuk kanë një mendim lidhur me këtë çështje.

Grafika 2: Përgjigjet e zyrtarëve përgjegjës të prokurimit

Rëndësi të veçantë, në kuadër të këtij kapitulli, i kushtohet anulimit të tenderëve për shkak të ngritjes së çmimeve të tregut e që në shumicën e rasteve anulimet arsyetohen me tejkalimin e vlerës së parashikuar nga OE, një dukuri relativisht prezente gjatë vitit 2022. Duke parë këtë situatë, INPO në kuadër të pyetësorit ka pyetur ZPP-të lidhur me këtë çështje. Pjesa më e madhe përgjigjeve të pranuar dëshmojnë se ngritja e çmimeve të tregut ka ndikuar në anulim të tenderëve për shkak të tejkalimit të vlerës së parashikuar për atë aktivitet. Një përgjigje të tillë siç edhe vërehet në tabelën më lart kanë ofruar: ZPP-të e komunave të Ferizajt, Gjakovës, Klinës, Podujevës dhe Shtimes.

8.1. Efektet negative dhe pasojat e anulimit të aktiviteteve të prokurimit

Procedurat e prokurimit publik, pavarësisht llojit dhe natyrës së kontratës nuk duhet të anulohen pa arsye të vlefshme. OE-të e interesuar të ofertojnë apo të cilët tashmë kanë ofruar investojnë kohë dhe burim në përgatitjen e ofertave të tyre dhe nuk presin anulimin e prokurimit si rezultat.

Rregullat e prokurimit publik lejojnë anulimin e procedurës për arsye të rëndësishme, në dhe për rrethana të paparashikuara, veçanërisht nëse dhënia e kontratës, për shkak të një ndryshimi të papritur të rrethanave, nuk është më në interesin publik. Nevoja për anulimin e një tenderi mund të jetë gjithashtu rezultat i veprimeve të paligjshme të OE-ve, kur jo rrallë herë ndodhe që të veprojnë në bashkëpunim për të kthyer situatën në favorin e tyre.

Tutje, mungesa e ofertimit apo ofertave të përgjegjshme detyron AK-në që të anulojnë aktivitetin, megjithatë AK-ja duhet të hulumtojë arsyet se pse asnjë ofertë apo ofertë të përgjegjshme nuk e ka pranuar. Zakonisht për këtë situatë problemi qëndron në planifikimin e prokurimit dhe hulumtimit të tregut.

Shpesh në Kosovë ndodhë që anulimi i procedurës të jetë i nevojshëm për të korrigjuar një tender që ka të meta në atë mënyrë që parregullsitë e kryera nga AK-ja të mos prodhojnë efekte më të rënda juridike dhe praktike.

Në të gjitha këto raste justifikimi i vendimit të anulimit duhet të jetë i ligjshëm, i argumentueshëm dhe përbëhet vetëm për arsye të paparashikueshme.

Në këtë kundërtën, AK-ja rrezikon të jetë subjekt i proceseve të gjata dhe të lodhshme të shqyrtimit të prokurimit dhe i procesve gjyqësore të cilat mund të rezultojnë me pasoja shkatërruese për AK-në. Në anën tjetër, anulimi i tenderëve pa arsye të vlefshme i pamundëson AK-së që të përmbushë objektivat institucionale dhe të ofrojnë shërbime të mira për qytetarë.

Gjatë planifikimit të prokurimit dhe dokumenteve të tenderit komunat duhet të sigurohen që kanë përfshirë dhe zbatuar të gjitha rregullat ligjore të cilat sigurojnë integritetin e procedurës dhe të cilat minimizojnë krijimin e rrethanave dhe rreziqeve për të anuluar procedurën.

9. Analizë aktiviteve të anuluar në njëzetë(20) komuna

INPO në njëzetë(20) komunat e monitoruara ka përzgjedh për monitorim aktivitetin e parë dhe aktivitetin e fundit për nga koha e anulimit të tij. Pra, për monitorim në secilën komunë është përzgjedhur aktiviteti i parë i anuluar i vitit 2022 dhe aktiviteti i fundit i vitit 2022, që është anuluar nga komuna përkatëse¹⁶. Qëllimi i monitorimit dhe analizimit ka të bëjë me shkaqet e anulimit të aktivitetit të prokurimit, përkatësisht ligjshmëria e anulimit të aktiviteve të prokurimit.

Në vazhdim janë paraqitur analiza të veçanta për secilën komunë të monitoruar, ku janë evidentuar të gjitha gjetjet lidhur me atë se si ka ardhur deri tek momenti i anulimit, arsyet e anulimit dhe shkeljet eventuale ligjore dhe procedurale gjatë këtij procesi.

9.1. Komuna e Deçanit

Komuna e Deçanit gjatë vitit 2022 ka anuluar gjithsej katër(4) aktivitete të prokurimit, por të cilat gjatë po të njëjtit vit i ka ri-tenderuar dhe tanimë janë nënshkruar kontratat. Meqë si aktivitete të anuluar në këtë hulumtim janë konsideruar vetëm aktivitetet të cilat janë anuluar dhe të cilat nuk janë ri-tenderuar, apo edhe ri-tenderimet kanë rezultuar të anulohen, konsiderohet që Komuna e Deçanit për të dytin vit me radhë nuk ka aktivitete të anuluar.

9.2. Komuna e Dragashit

Komuna e Dragashit në vitin 2022 ka gjithsej tri(3) aktivitete të anuluar, dhe për monitorim janë përzgjedhur aktiviteti “Ndërtimi i rezervuarit të ujit rruga Turbe në fshatin Restelicë” me vlerë të parashikuar 20,280.64 euro.¹⁷ Ndërsa aktiviteti i dytë i monitoruar është “•I65•Furnizimi me material hixhienik për shkollat e Komunës së Dragashit dhe Q.K.M.F. Dragash”, me vlerë të parashikuar 9,700.00 euro.¹⁸

Aktivitetin “Ndërtimi i rezervuarit të ujit rruga Turbe në fshatin Restelicë”, AK-ja e ka anuluar në përputhje me dispozitat ligjore, ngase për këtë aktivitet nuk ka ofertuar asnjë OE. Megjithatë nga Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve, mësojmë se ky aktivitet nuk ishte i përfshirë në parashikimin e prokurimit, andaj është rrezik potencial që aktiviteti të mos jetë hartuar në përputhje me planet dhe parashikimet e tregut.

Aktiviteti për “•I65•Furnizimi me material hixhienik për shkollat e Komunës së Dragashit dhe Q.K.M.F. Dragash” është anuluar pas hapjes së ofertave nga AK-ja, me arsyetimin se “Autoriteti kontraktues K.K Dragash anulon aktivitetin e prokurimit për arsye se Operatori Ekonomik i shpërblyer me kontratë nuk ka ofruar dokumentet e kërkuara (Vërtetimin e ATK-së dhe Gjykatës Ekonomike) dhe ka shkaktuar vonesa për nënshkrimin e kontratës, ku do të veprohet konform nenit 99 pika 2 të ligjit të prokurimit, si dhe këto mjete janë fondi i grandit qeveritar ku nuk mund të shfrytëzohen brenda këtij viti fiskal si dhe për shkak se disa njësi kërkuese kanë paraqitur nevojën për material hixhienik, ku konstatojmë se ky

¹⁶ **Sqarim:** Aktivitetet e anuluar sipas kohës në të cilën janë anuluar i gjeni të bashkangjitur në Aneks I. Sipas atyre listave janë përzgjedh për monitorim aktiviteti i parë dhe i fundit.

¹⁷ Shih aktivitetin e prokurimit: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1992380

¹⁸ Shih aktivitetin e prokurimit: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2276562

tender duhet të anulohet dhe të fillojë procedurën nga fillimi”. Siç u tha në arsyetimin e anulimit të aktivitetit të prokurimit, AK-ja fillimisht e kishte shpërblyer me kontratë “PM Group” Sh.P.K me dokumentin B58 - Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 09.12.2022. Pas përzgjedhjes, AK-ja ka kërkuar nga OE dokumentet e nevojshme si Vërtetimet e ATK-së dhe Vërtetimet e Gjykatës Ekonomike, në të cilën AK-ja pranon përgjigjen nga OE se “menaxheri ka gabuar në vendosjen e çmimeve dhe oferta është dërguar gabimisht, me këto çmime nuk kemi mundësi të ju furnizojmë sepse çmimet janë rritur”. Tutje, në vendimin e saj AK-ja ka kërcënuar OE-në duke paralajmëruar se “do të veprohet konform nenit 99 pika 2 e ligjit të prokurimit”, AK-ja edhe kishte qëndruar prapa këtij deklarimi, por të cilin OshP-ja me vendimin e datës 26.02.2022 e refuzon si të pabazuar. AK-ja kishte zgjedhur institucionin e gabuar kur i është drejtuar OShP-së, ngase ligji qartë shprehet kur thotë se “Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare”, në një gjendje të tillë është dashur të i drejtohet gjykatës kompetente për kompensim të dëmeve të shkaktuara.¹⁹

Tutje, sipas Raportit të Vlerësimit të Tenderëve të datës 09.12.2022, komisioni ka deklaruar se “Të gjithë operatorët ekonomikë i plotësojnë të gjitha kriteret sipas njoftimit për kontratë ku sipas kriterit çmimi më i lirë, komisioni rekomandon ZPP-në që të shpërblejë me kontratë OE PM Group Sh.P.K me çmim prej 5.256.50 euro. Lidhur me këtë konsiderojmë që AK është dashur të vazhdoj me OE-në tjetër në radhë dhe kështu duke dërguar në nënshkrim të kontratës dhe jo të anulojë aktivitetin në tërësi për shkak të refuzimit të OE-së për të nënshkruar kontratën. Kjo të njëjtën kohë i jep të drejtë AK-së që të padisë OE-në dhe anasjelltas.

9.3. Komuna e Ferizajt

Komuna e Ferizajt ka gjithsej dhjetë(10) aktivitete të anuluar për vitin 2022. Aktivitetet e monitoruara janë “Furnizim me material shpenzues të stomatologjisë për nevojat e QKMF-së” me vlerë të parashikuar 66,850.00 euro.²⁰ Aktiviteti i dytë i monitoruar është “Furnizimi i fermerëve me koshere të bletëve” me vlerë të parashikuar prej 40,000.00 euro.²¹

Aktivitetin “Furnizim me material shpenzues të stomatologjisë për nevojat e QKMF-së” Komuna e ka anuluar para hapjes së ofertave me arsyetimin se “Gabim teknik nga njesia kërkuese”. Kujtojmë se përfundimi i një aktiviteti para hapjes mund të bëhet vetëm për shkak të ngjarjeve, si “ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontaktues dhe që nuk mund të parashikoheshin në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit”.²² Kësisoj aktiviteti i inicimit kalon nëpër disa faza të cilat duhet të rishikohet, andaj dhënia e arsyeve të tilla duke fajtuar njësin kërkuese janë të paqëndrueshme dhe dëmi që shkaktohet nga ky aktivitet i cili ka paraparë

¹⁹ Ligji Nr. 04/I-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës Neni 99 par. 2 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>

²⁰ Shih aktivitetin e prokurimit: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1730867

²¹ Shih aktivitetin e prokurimit: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1770543

²² Ligji Nr. 04/I-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës Neni 62 par. 1.3 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>

materiale të domosdoshme për stomatologji janë të mëdha. Përkundër që AK-ja këtë aktivitet e kishte planifikuar me planin e prokurimit të vitit 2022 me vlerë 33.416,00 euro, i njëjti institucion këtë aktivitet nuk ka arritur që ta ritenderojë gjatë vitit 2022.²³

Edhe aktivitetin “Furnizimi i fermerëve me koshere të bletëve”, AK-ja e ka anuluar para hapjes së ofertave, me arsyetimin se “Pas nje gabimi teknik në e-prokurim detyrohemi të bëjmë anulimin e kësaj procedure”. INPO ka gjetur se ayseja e anulimit të procedurës së prokurimit është vendimi i me vendimin i Oshp-se, PSH. Nr. 440/22 i dates 02.11.2022, i cili obligon komunën të bëjë anulimin e njoftimit për kontratë dhe që të eliminojë kriteret kufizuese në tenderët e ardhshëm.

Pas ankesave të OE NTP “Bletaria Egzoni” në AK dhe më pas në OshP, kundër njoftimit për kontratë, respektivisht kundër specifikimeve teknike të detyrueshme me karakter diskriminues OShP-ja me vendimin PSH. Nr. 440/22 i dates 02.11.2022, anulon njoftimin për kontratë. Ndërkaq, AK-ja më 18.11.2022, pra pas vendimit të OshP-së, kishte publikuar paramasën me ndryshime për këtë tender. Tutje, më 30.11.2022, njëzet e tetë(28) ditë më vonë nga vendimi i OShP-së kishte njoftuar OE-të e që “për shkaqe teknike (problem në sistemin E-prokurimi) do të shtyhet afati për dorëzim të ofertave”. Rrjedhimsht, AK-ja kishte vazhduar me këtë aktivitet të prokurimit në kundërshtim me vendimin e OshP-së. Tutje, INPO ka gjetur se ky tender nuk është anuluar sipas procedurave ligjore, ku përveç mos respekimit të vendimit të OShP-së, komuna nuk ka publikuar formularin B58, respektivisht Njoftimin Mbi Vendimin e AK-së, por ka publikuar vetëm formularin B10, në të cilin arsyetimi për anulimin e prokurimit nuk është i vërtetë.

9.4. Komuna e Glllogocit

Komuna e Glllogocit në vitin 2022 ka gjithsej shtatë(7) aktivitete të anuluar. Aktivitetet e monitoruara janë “Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i objekteve shëndetësore”, me vlerë të parashikuar 15,000.00 euro.²⁴ Aktiviteti i dytë është “Ndërtimi i kapaciteti të ujësjellësit - Projekt dyvjeçar”, me vlerë të parashikuar 300,000.00 euro.²⁵

Aktiviteti “Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i objekteve shëndetësore”, është anuluar para hapjes me arsyetimin se “Nuk kemi qenë te njoftuar me Udhëzimet e reja për emërtimin e ISO Standardeve dhe emërtimin e Licencës. Drejtori i ka shkruar një kërkesë Ministrisë së Shëndetësisë për specifika dhe kriteret dhe jemi në pritje të një përgjigje. Menjëherë po sa të marim përgjigje nga MSH do të kërkojmë vazhdimin e aktivitetit të prokurimit”.

OE “Monuni” Sh.P.K, kishte dërguar kërkesë për informacione shtesë për vendosjen e kriterit “Të jetë i certifikuar me ISO standardin OHSAS 18001 2018 për mbrojtje në punë e preparate dhe substanca të ndryshme”, dhe duke i sqaruar AK-së se kjo ISO është zëvendësuar në vitin 2021 me ISO 45001:2018. Tutje OE kishte kërkuar sqarime edhe për licencën për të ushtruar veprimtari të D.D.D-së, me të cilën është konsideruar e arsyeshme, por duke kundërshtuar stafin e kërkuar me tituj akademikë, p.sh. 2.4. “një epidemolog të diplomuar me licencë të punës”, e cila ka sqaruar se

²³ Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit nga Komuna e Ferizajt, data e dërgimit në AQP 05.01.2022.

²⁴ Shih aktivitetin: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1975137

²⁵ Shih aktivitetin e prokurimit: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2276854

ka zvogëluar konkurrencën kur ka vendosur këto kritere. Lidhur me këtë INPO është informuar nga Oda e Mjekëve të Kosovës (OMK) se në Kosovë janë të licencuar – rilicencuar vetëm 34 mjekë specialistë të epidemiologjisë.²⁶ AK-ja me pranimin e kësaj shkrese të datës 14.07.2022, kishte anuluar aktivitetin me arsyetimet e lartëcekura me Dokumentin B10 të datës 15.07.2022. Këtë aktivitet AK-ja e ka anuluar në mënyrë të kundërligjshme, ngase është dashur të vepronte konform Rregullores për Prokurim Publik, të ndryshojë kërkesat e dosjes së tenderit dhe të zgjasë afatin për pranimin e ofertave. OE-ja kishte dërguar kërkesën për rishqyrtim në AK më 14.07.2022, afati i fundit për dorëzimin e ofertave ishte 26.07.2022, ndërkaq anulimi i aktivitetit të prokurimit është bërë më 18.07.2022.²⁷ Komuna nuk e ka ritenderuar këtë aktivitet gjatë vitit 2022.

Aktiviteti “Ndërtimi i kapaciteti të ujësjellësit - Projekt dyvjeçar” është anuluar nga OShP-ja për faktin se AK-ja nuk kishte hartuar fare Projektin Ekzekutues dhe kështu kishte vepruar në kundërshtim me nenin 28 të LPP-së. Në vendimin për kërkesën për rishqyrtim të datës 25.11.2022, AK-ja kishte deklaruar që “AK nuk e posedon projektin pasi nuk kemi hartuar projekt për ekzekutim të rrjetit të ujësjellësit duke qenë se neve si AK na ndikon në kosto, mirëpo kjo nuk do të thotë që nuk janë analizuar me kujdes të gjitha pozicionet në paramasë dhe parallogari”. Lidhur me këtë Rregullorja për Prokurim publik e rregullon në mënyrë të qartë çështjen e Projektit Ekzekutues, në të cilin shprehimisht thuhet se “Projektin Ekzekutues është një dizajn grafik i të gjitha proceseve administrative dhe inxhinierike të punimeve të kërkuara siç është përshkruar në Specifikat Teknike dhe prandaj, parashtron, në raste të veçanta, punime arkitektonike, strukturore të punëve që do të ekzekutohen. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t’i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.”²⁸ Lidhur me këtë konstatojmë që aktiviteti pa Projekt Ekzekutues nuk është dashur të iniciohet fare, andaj veprimi i AK-së në kundërshtim me dispozitat ligjore ka çuar në anulimin e aktivitetit të prokurimit.

9.5. Komuna e Gjakovës

Komuna e Gjakovës gjatë vitit 2022 ka anuluar gjithsej katërbëdhjetë(14) aktivitete të prokurimit, ndërsa aktiviteti i parë dhe i fundit i anuluar, e të cilët janë përzgjedhur për monitorim janë aktiviteti “Transporti i nxënësve në relacione të ndryshme”²⁹, përkatësisht LOT III Transporti i nxënësve në relacionin Smaql Bishtazhin dhe anasjelltas me vlerë të parashikuar 2,300.00 euro dhe aktivitetin “Rregullimi i shtratit të Lumit Krena”³⁰, me vlerë të parashikuar 656,741.41.

²⁶ Komunikimi i datës 11.08.2023 nga Oda e Mjekëve të Kosovës.

²⁷ Rregullore Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, neni 24.5, https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/Rregullore%20Nr.001_2022%20p%C3%ABr%20prokurimin%20publik.pdf

²⁸ Lexo më shumë në: Rregullore Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, neni 19.17 dhe 19.18, https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/Rregullore%20Nr.001_2022%20p%C3%ABr%20prokurimin%20publik.pdf

²⁹ Shih aktivitetin e prokurimit: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1807149

³⁰ Shih aktivitetin e prokurimit: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2325074

Aktivitetin “Transporti i nxënësve në relacione të ndryshme”, Komuna e Gjakovës e ka anuluar me të drejtë dhe në përputhje me kërkesat ligjore, pasi që për këtë llot nuk kishte ofertuar asnjë operator ekonomik.

Aktivitetin “Rregullimi i shtratit të Lumit Krena”, Komuna e Gjakovës e ka anuluar bazuar në vendimin e OShP-së. Fillimisht, Komuna e Gjakovës për këtë aktivitet të prokurimit kishte shpërblyer me kontratë OE-në “Roza Komani” dhe i pakënaqur me këtë vendim OE “V.B Totaj”, pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga ana e Komunës së Gjakovës, i drejtohet për apelim në shkallë të dytë, rrjedhimisht pranë OShP-së. OShP-ja pas analizimit të të gjitha pretendimeve ankimore të palës ankuese, me anë të vendimit PSH.nr.760/22 kërkon të anulohet në tërësi ky aktiviteti i prokurimit. Pas monitorimit të INPO-s rezulton se anulimi është në përputhje me kërkesat ligjore, në mungesë të ofertave të përgjegjshme.

INPO për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, ka kërkuar nga ana e Komunës së Gjakovës, Njoftimin mbi Vendimin e AK-së, dokument ligjor i cili duhet të nxirret për çdo aktivitet të anuluar, ashtu siç e parasheh neni 43.1 i Rregullores nr. 001/2022 të prokurimit publik, e cila taksativisht thekson se: “Në rast të vendimit të anulimit të procedurës së prokurimit, AK menjëherë do të përgatisë dhe do të publikojë Formularin B58 - Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues - ku paraqiten arsyet faktike dhe bazën ligjore të anulimit të tillë”, mirëpo të njëjtit kanë deklaruar se “Vendimi i OShP është i mjaftushëm dhe komuna nuk ka nevojë të nxjerr ndonjë dokument shtesë”

9.6. Komuna e Gjilanit

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjilanit, gjatë vitit 2022 ka anuluar nëntë(9) aktivitete të prokurimit. Aktiviteti i parë i anuluar është “Shërbime Konsulente Individuale për nevoja të Komunës së Gjilanit”, me vlerë të parashikuar 211,116.00 euro.³¹ Aktiviteti i dytë “Asfaltimi, kanalizimi dhe ndriçimi publik në rrugën Nëna Terezë”, me vlerë të parashikuar 512,625.00 euro.³²

Aktiviteti “Shërbime Konsulente të Individuale për nevoja të Komunës së Gjilanit” është anuluar para hapjes së ofertave me gjithsej dyzet e katër (44) lloje, duke mos dhënë arsyetimin e anulimit në Dokumentin B10, por duke e deklaruar në Dokumentin B58 se “Komuna e Gjilanit vendos të anulojë aktivitetin e prokurimit duke u bazuar në rekomandimin e KRPP-së të datës 13.04.2022”. KRPP në këtë datë kishte rekomanduar AK-së “të vlerësoj edhe njëherë se aktiviteti i prokurimit, a është në përputhje me rregulloren për shërbime të veçanta si dhe me njoftimin e KRPP-së të datës 02.02.2021”.

Rrjedhimisht anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është i arsyeshëm, meqenëse përmes këtij tenderi ishte synuar që të rekrutohej staf për pozita të rregullta të shërbimit civil brenda administratës publike komunale, mirëpo publikimi i këtij tenderi ishte në kundërshtim me LPP dhe ligjet tjera që rregullojnë aspektet e rregullave dhe procedurave që duhet ndjekur institucioni publik për rekrutimin e stafit.

³¹ Shih aktivitetin e prokurimit: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1827095

³² Shih aktivitetin e prokurimit: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2520580

Për aktivitetin “Asfaltimi, kanalizimi dhe ndriçimi publik në rrugën Nëna Terezë”, AK në Dokumentin B58 të datës 23.01.2023, sqaron që arsyeja e anulimit është se “njësia kërkuese ka konfirmuar që nuk ka mjete për të vazhduar me këtë aktivitet të prokurimit”. Më datë 30.01.2023, OE “EL-BAU” Sh.P.K., parashtron kërkesë për rishqyrtim në AK. Më datën 31.01.2023, AK-ja me vendim refuzon kërkesën për rishqyrtim të OE-së ankuese. E pakënaqur me vendimin e AK-së, OE-ja ankuese “EL-BAU” Sh.P.K., më datë 08.02.2023, parashtron ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0070, kundër njoftimit për kontratë të AK-së. OshP-ja me vendimin e datës 13.06.2023 e hedh poshtë si të palejuar ankesën e OE-së “EL-BAU” SH.P.K, pasi që “OE-ja ankuese konsiderohet palë pa interes juridik material, konform nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së”. Është e paqartë se si ka ardhur deri tek mungesa e mjeteve, pasi që projekti kishte DNDF-në të datës 02.08.2022. AK-ja paraprakisht kishte një marrëveshje të mirëkuptimit ndërmjet AK-së Komuna e Gjilanit dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nënshkruar më 31.05.2022, e cila kishte krijuar detyrimin që procedurat e prokurimit t’i zhvillojë nga viti 2022, për arsye se marrëveshja është 24 muaj. AK-ja e ka anuluar aktivitetin e prokurimit pas hapjes së ofertave në mënyrë të kundërligjshme, sepse me arsyet e cekura ka mundur që aktivitetin e prokurimit ta anulojë para hapjes, mirëpo jo të anulojë aktivitetin pasi që AK-ja ka mësuar së cilët janë OE-të ofertues. AK-ja kishte vepruar në kundërshtim me Rregulloren për Prokurim Publik edhe kur e kishte vlerësuar apo kur kishte prodhuar Dokumentin B58, pasi që AK-së i janë dashur dyzet e dy (42) ditë për të nxjerrë Dokumentin B58, e kjo pasi që rregullorja parasheh afatin jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave, me përjashtim për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Siç shihet nga e-prokurimi AK-ja nuk ka ndonjë dokument që vërteton zgjatjen e afatit të vlerësimit të ofertave. Këto veprime e bëjnë komunën cak të padive për kompensim të dëmit të parashtruar nga OE-të.

9.7. Komuna e Kaçanikut

Komuna e Kaçanikut ka gjithsej katër(4) aktivitete të anuluar përfundimisht. Aktiviteti i parë i monitoruar është “Shërbime kontraktuale - Specialist i Gjinekologjisë”, me vlerë të parashikuar 14,400.00 euro.³³ Aktiviteti i dytë i monitoruar është “Mirmbajtja e ndriçimit publik”, me vlerë të parashikuar 50,000.00 euro.

Aktivitetin “Shërbime kontraktuale - Specialist i Gjinekologjisë”, Komuna e ka anuluar pas hapjes së ofertave me arsyetimin se “Nuk është paraqitur asnjë ofertë”. Mirëpo AK-ja nuk ka publikuar fare dokumentin B12 - Proces verbali i hapjes së Tenderëve, dhe dokumentin B58 - Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues. INPO pas analizimit, në procesverbalin e hapjes ka gjetur se për këtë tender nuk kishte oferta, ashtu sikur kishte deklaruar AK-ja, si dhe ka gjetur se AK-ja nuk kishte prodhuar fare dokumentin B58 - Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues.³⁴

INPO ka gjetur se anulimi i këtij tenderi është i arsyeshëm sipas LPP-së meqenëse nuk ka pasur asnjë ofertë, por vlerëson se iniciimi i tenderit ka qenë në kundërshtim me LPP-në, pasi që për rekrutimin e stafit mjekësor nuk mund të aplikohen procedurat dhe rregullat e prokurimit.

³³ Shih aktivitetin e prokurimit: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1931519

³⁴ Ligji Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike neni 6, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20505>

Aktivitetin “Mirmbajtja e ndriqimit publik”, komuna e ka anuluar pas hapjes me arsyetimin e “Bazuar në Vendimin e OShP-së me nr. 797/22 të datës 21.03.2023”.³⁵ INPO ka analizuar vendimin e ankesës së OE-së më të lirë, “Toni Ingjinjering” Sh.P.K, me të cilin OShP-ja e anulon në tërësi aktivitetin e prokurimit si dhe Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës. AK-ja në këtë aktivitet nuk kishte trajtuar operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë në përputhje me nenin 7 të LPP-së, i cili thotë që “Autoriteti kontraktues do t’i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”. AK-ja nuk kishte trajtuar të gjithë OE-të në mënyrë të barabartë. Pra AK-ja ka trajtuar vetëm OE-në e ankuar, ndërsa nuk ka kërkuar sqarime të tenderit të rekomanduar, meqenëse edhe OE-ja e rekomanduar për kontratë në disa pozicione ka ofruar çmime më të ulëta në raport me çmimet reale të tregut.

9.8. Komuna e Kamenicës

Komuna e Kamenicës gjatë vitit 2022 ka vetëm dy(2) aktivitete të anuluar, dhe të njëjtat janë të monitoruara. Aktiviteti i parë është “Marrëveshje kornizë - Furnizim me pemë dhe perime”, me vlerë të parashikuar 3,399.00 euro.³⁶ Aktiviteti i dytë është “Furnizim me kamera dhe pajisje tjera për teknologji informative”, me vlerë të parashikuar 9,370.00 euro.³⁷

Aktiviteti “Marrëveshje kornizë - Furnizim me pemë dhe perime” është anuluar në përputhje me ligjin e prokurimit, ngase AK-ja nuk ka pranuar asnjë ofertë sipas procesverbalit të hapjes së ofertave të datës 21.10.2022, andaj rrjedhimisht është i domosdoshëm anulimi i aktivitetit të prokurimit. Është e çuditshme se si në shkresën njoftuese për inicim të aktivitetit të prokurimit të datës 13.10.2022, të zotuar si mjete për këtë aktivitet, AK-ja ka vetëm 980.00 euro, ndërsa në DNDF 3,399.00 euro. Gjithashtu lidhur me anulimin e aktivitetit, AK-ja nuk ka prodhuar fare Dokumentin B58. Këtë e vë në pah edhe komuna në deklarinimin se “nuk ka pasur ofertues dhe është bërë direkt anulimi i aktivitetit”.

Aktiviteti “Furnizim me kamera dhe pajisje tjera për teknologji informative” është anuluar me vendimin e AK-së më 17.11.2022, me arsyetimin se “në mungesë të ofertave të përgjegjshme dhe për shkak të çmimeve të larta të llogaritura që janë vendosur gjatë ofertimit”. OE-së N.P.Sh “AFA-ING” e kishte konsideruar si anulim të padrejtë dhe se komuna nuk e ka trajtuar ofertën e tij. OShP-ja pas shqyrtimit kishte vërtetuar vendimin e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

9.9. Komuna e Klinës

Komuna e Klinës gjatë vitit 2022 ka anuluar dy (8) aktivitete të prokurimit, të cilat edhe janë monitoruar lidhur me ligjshmërinë e anulimit. Titujt e aktiviteteve të anuluar në tërësi janë

³⁵ Shih aktivitetin e prokurimit: https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2362171

³⁶ Shih aktivitetin e prokurimit: https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2159866

³⁷ Shih aktivitetin e prokurimit: https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2285315

“Furnizim me shujta ditore për nxënës” me vlerë të parashikuar 93,264.00 euro.³⁸ Aktiviteti “Ndërtim i stacionit të autobusave faza II” me vlerë të parashikuar 90,000.00 euro³⁹

Aktivitetin “Furnizim me shujta ditore për nxënës”, Komuna e Klinës e ka anuluar me arsyetimin se ky aktivitet është i autorizuar nga AQP-ja. INPO vlerëson se komuna e Klinës ka vepruar në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ për zbatimin e procedurave qendrore të prokurimit publik, me anë të të cilit parashihen produktet për të cilat prokurimet i udhëheq AQP-ja,⁴⁰ dhe se ky tender nuk është dashur të inicohej fare.

Aktivitetin “Ndërtim i stacionit të autobusave faza II”, Komuna e Klinës e ka anuluar me arsyen se nuk ka pranuar asnjë ofertë të përgjegjshme. Pas monitorimit të INPO-s, edhe ky anulim rezulton të jetë i ligjshëm për faktin se AK-ja ka pranuar vetëm një ofertë nga OE-të dhe e njëjta rezulton të jetë e papërgjegjshme, rrjedhimisht OE-ja nuk ka përmbushur kërkesat e pranueshmërisë dhe përshtatshmërisë profesionale.

9.10. Komuna e Leposaviqit

Për shkak të mungesës së komunikimit me komunat veriore, INPO nuk ka mundur të shtrijë monitorimin e procedurave të prokurimit, përkatësisht anulimin e tenderëve për vitin 2022 në Komunën e Leposaviqit. Mirëpo, deri në nëntor të vitit 2022 në komunën e Leposaviqit janë anuluar pesë(5) aktivitete të prokurimit, të cilat në mungesë të dokumenteve nuk kanë mundur të analizohen lidhur me ligjshmërinë e anulimit të tyre.

9.11. Komuna e Mitrovicës së Veriut

Për shkak të mungesës së komunikimit me komunat veriore, INPO nuk ka mundur të shtrijë monitorimin e procedurave të prokurimit, përkatësisht anulimin e tenderëve për vitin 2022 në Komunën e Mitrovicës së Veriut. Mirëpo, deri në nëntor të vitit 2022 në Komunën e Mitrovicës së Veriut është anuluar vetëm një (1) aktivitet i prokurimit, i cili në mungesë të dokumenteve nuk ka mundur të analizohet lidhur me ligjshmërinë e anulimit të tij.

9.12. Komuna e Pejës

Komuna e Pejës gjatë vitit 2022 ka anuluar dy (2) aktivitete të prokurimit, të cilat janë monitoruar edhe sa i përket ligjshmërisë së anulimit, andaj ato janë “Blerja e një autokombi për QKMF-në- Llot 2” me vlerë të parashikuar 30.000.00.⁴¹ Aktiviteti “Mirëmbajtja verore e rrugëve në Rugovë” me vlerë të parashikuar 90,000 euro.⁴²

Aktiviteti “Blerja e një autokombi për QKMF-në - Llot 2”, është anuluar për shkak se AK-ja në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë ka paraparë që për këtë aktivitet të prokurimit, i cili ishte i

³⁸ Shih aktivitetin e prokurimit, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1733020

³⁹ Shih aktivitetin e prokurimit, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2275692

⁴⁰ Për më shumë shih udhëzimin administrativ: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18812>

⁴¹ Shih aktivitein e prokurimit, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1798709

⁴² Shih aktivitetin e prokurimit, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2272890

ndarë në dy lloje, të shpërblehet me kontratë një operator ekonomik për një llot. Andaj, në këtë rast, vetëm një OE ka ofertuar për të dyja llotet.

I njëjti aktivitet prokurimi është ritenderuar, mirëpo nuk ka arritur të nënshkruhet kontrata dhe ka rezultuar në anulim të tërësishëm.

Aktivitetin “*Mirëmbajtja verore e rrugëve në Rugovë LOT II*”, Komuna e Pejës e ka anuluar bazuar në vendimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit PSH. Nr. 620/22, përkundër që i njëjti aktivitet pas vlerësimit dhe rivlerësimit, Komuna e Pejës e kishte shpërblyer me kontratë dy operatorë ekonomikë të ndryshëm. Sidoqoftë, pas paraqitjes së ankesës ky aktivitet është anuluar pas konstatimit nga OShP-ja se AK-ja ka shpërblyer me kontratë operatorin e papërgjegjshëm.⁴³

9.13. Komuna e Podujevës

Komuna e Podujevës gjatë vitit 2022 ka anuluar gjithsej katër (4) aktivitete të prokurimit. Aktivitetet të cilat i janë nënshtruar monitorimit lidhur me ligjshmërinë e anulimit janë aktiviteti me titull “*Furnizim me shoqëri bletësh dhe koshere*” me vlerë të parashikuar 65,000.00 euro.⁴⁴ Aktiviteti “*Podujeva për efikasitet dhe zhvillim efikas*, me vlerë të parashikuar 170,944.40 euro.⁴⁵

Aktivitetin “*Furnizim me shoqëri bletësh dhe koshere*”, Komuna e Podujevës e ka anuluar me arsyen se nuk ka pasur OE të përgjegjshëm. Pas monitorimit të INPO-s rezulton se për këtë aktivitet kanë ofertuar gjithsej dy(2) OE dhe të dy OE-të kanë tejkalluar vlerën e parashikuar të aktivitetit dhe në rrethana të tilla, sipas ligjit dhe rregullave për prokurim publik, anulimi konsiderohet i ligjshëm.

Edhe aktiviteti “*Podujeva për efikasitet dhe zhvillim efikas*”, është anuluar me arsyen se AK-ja nuk ka pranuar asnjë ofertë të përgjegjshme. Pas monitorimit të ligjshmërisë së anulimit të këtij aktiviteti, rezulton se Komuna e Podujevës me të drejtë ka anuluar edhe këtë aktivitet të prokurimit, pasi që dy (2) OE-të kanë tejkalluar vlerën e parashikuar të aktivitetit të prokurimit dhe përveç kësaj, sipas raportit të vlerësimit të dy(2) OE-të nuk i kanë përmbushur kushtet e dosjes së tenderit.

9.14. Komuna e Prishtinës

Autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës gjatë vitit fiskal 2022 ka anuluar gjithsej njëzet e tri (23) aktivitete të prokurimit. Aktiviteti i parë i monitoruar është për “*Furnizim me material shpenzues administrativ për nevojat e Komunës së Prishtinës*”, me vlerë të parashikuar 100,000.00

⁴³ Për më shumë shih raportin e ekspertit shqyrtues nr. 620/22 të datës 18.11.2022 dhe vendimin e OShP nr. 620/22 të datës 28.12.2022: https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Search?__RequestVerificationToken=lgzAjZxunnVLTqFAëgAtD0lJCtcUNiYoFgkIjLLeYxxCkllKddu3oDMlEoGJ_KnsëqRBdB3lUQP5EqcRNI5gbGKyHroEBTNQFZYa0BNgSDII&ProcurementNumber=635-22-8396-2-1-1&ContractingAuthorityId=&EconomicOperatorId=

⁴⁴ Shih aktivitetin e prokurimit, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2378933

⁴⁵ Shih aktivitetin e prokurimit, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2263505

euro.⁴⁶ Aktiviteti i dytë i monitoruar është “*Master plani per rigjenerimin e lagjes Kolovica*”, me vlerë të parashikuar 400,000.00 euro.⁴⁷

Aktiviteti “*Furnizim me material shpenzues administrativ për nevojat e Komunës së Prishtinës*” është anuluar një (1) ditë para afatit për dorëzimin e ofertave. Në lidhje me këtë AK-ja është e përfshirë në kontratë të centralizuar përmes Agjencisë Qendrore të Prokurimit dhe e cila është aktive deri më 22.04.2024.⁴⁸ AK-ja kishte shkurtuar afatet në mënyrë të kundërligjshme nga njëzet (20) ditë sa e parasheh ligji, në vetëm tre (3) sosh me arsyetimin se “*Meqenëse Kontrata e centralizuar në AQP nuk është duke u implementuar dhe ka vështirësi në përmblyllje procedurale, Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës duke marrë për bazë edhe faktin që ka nevojë shumë urgjente për furnizim me material administrativ për Letër dhe Regjistrator për arkivim të lëndëve, atëherë kërkon që të bëjë procedurë me afat të shkurtuar*”. Në thelb ky aktivitet nuk është dashur të iniciohet fare për shkak që ka pasur kontratë aktive, por edhe pas inicimit AK-ja ka bërë shkelje duke shkurtuar afatin në kundërshtim me ligjin e prokurimit dhe rregullat sekondare.

Aktivitetin “*Master plani per rigjenerimin e lagjes Kolovica*”, AK-ja e ka anuluar pas hapjes, me rekomandimin e komisionit vlerësues të ofertave të katër (4) OE-ve, me arsyetimin se të gjithë OE-të ishin të papërgjegjshëm. Pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, OE-ja “*Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë - INSI*” Sh.P.K bën ankesë në OShP, të cilin me vendim nuk e ndryshon vendimin e AK-së dhe anulon në tërësi aktivitetin e prokurimit. OE-ja e paknaqur i drejtohet Gjykatës Komerciale të Kosovës, në të cilën palë e paditur është OShP-ja për shkak të vendimit për anulim PSH. Nr.19/23 të datës 26.04.2023, me të cilën OE-ja ka kërkuar vendosjen e masës së përkohshme për shtyerjen e ekzekutimit të vendimit të OShP-së, që në Dhomat e Shkallë së Parë dhe të Dytë janë refuzuar, dhe ende nuk kemi një Aktgjykim në lidhje me padinë e paditësit.⁴⁹ Tutje AK-ja në platformën e-prokurimi nuk ka ngarkuar fare procesverbalin e hapjes së ofertave. INPO përmes kërkesës për qasje ka siguruar dokumentin i cili mban datën 08.11.2022 (dita e fundit për pranimin e ofertave), me të cilin pas dyzetë e nëntë (49) ditëve me datë 27.12.2022, përgatit Raportin e Vlerësimit, ndërsa në ditën e pesëdhjetë (50), me datë 28.12.2022 publikon Dokumentin B58 - Njoftimi Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me afat të stërzgatur. Andaj AK-ja është dashur ta fillonte procesin e vlerësimit menjëherë pas hapjes së ofertave dhe jo duke e shtyer deri në pesëdhjetë (50) ditë.

⁴⁶ Shih aktivitetin e prokurimit: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1842460

⁴⁷ Shih aktivitetin e prokurimit: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2431427

⁴⁸ Shih kontratën: <https://aqp.rks-gov.net/ep-content/uploads/2021/06/Furnizim-me-material-shpenzues-zyrtar-LOT-3-2021.pdf>

⁴⁹ Shih më shumë në lidhje me ankesën: https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Search?__RequestVerificationToken=iNe6O7oRzrGLO4Lu7rLuRSInuB-VUIEgQ7afMrPKf27kgagnN2fm5r6NfPeKkZq8-Hh-Z3bByJR7dTkVëVRdFIH9ReEb9eRqE98Nfk6AI&ProcurementNumber=616-22-10260-2-1-1&ProtocolNr=&ContractingAuthorityId=&TenderCategoryId=&Title=&TenderValueId=&EconomicOperatorId=&RecommendedEOId=&ContractValueFrom=&ContractValueTo=&OfferValueFrom=&OfferValueTo=&DateAcceptedFrom=&DateAcceptedTo=&ComplaintStatusId=

9.15. Komuna e Prizrenit

Gjatë vitit 2022, Komuna e Prizrenit ka anuluar gjithsej trembëdhjetë (13) aktivitete të prokurimit, ndërsa aktivitetet e përzgjedhura për monitorim janë aktiviteti “Furnizim me libreza sanitare për stafin e kujdesit parësor në Komunën e Prizrenit”, me vlerë të parashikuar 12,000.00 euro.⁵⁰ Aktiviteti i dytë i monitoruar është “Menaxhimi i projekteve të Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Prizrenit”, me vlerë të parashikuar 150,000.00 euro.⁵¹

Aktivitetin “Furnizim me libreza sanitare për stafin e kujdesit parësor në Komunën e Prizrenit”, me të cilin parashihej pajisja me libreza sanitare për punëtorët e shëndetësisë primare në Komunën e Prizrenit, e ka anuluar me të drejtë sepse nuk ka pasur asnjë interesim për ofertim nga operatorët ekonomikë. Kjo ka ndodhur edhe përkundër faktit që AK-ja kishte zgatur afatin për dorëzimin e ofertave për shtatë (7) ditë dhe bazuar në dispozitat ligjore në këtë rast aktiviteti i prokurimit duhet të anulohet.

Aktiviteti “Menaxhimi i projekteve të Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Prizrenit” është anuluar pas hapjes së ofertave. Në Dokumentin B10, AK-ja ka dhënë informata të pasakta dhe kështu në pyetjen se a është anuluar para apo pas hapjes, AK-ja është pëgjigjur se para hapjes. Tutje informata të pasakta ka dhënë edhe në Deklaratën e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve, duke mos plotësuar kështu të dhënat si: Numrin e Prokurimit, parashikimin e prokurimit dhe pyetjen se a është ky projekt shumëvjeçar. Arsyetimi i AK-së për anulim të aktivitetit në Dokumentin B58 i datës 15.09.2022 ishte që “Nuk kemi OE të përgjegjshëm”. Këtë arsyetim e kishte dhënë me dyshime, ku AK-ja nuk ka argumentuar vendimin në mënyrë të qartë, ku në Dokumentin B42 - Letër standarde për Tenderuesin - Kandidatin e Eliminuar, thotë se “Dy anëtarë të grupit UNIVERS-MI dhe Instituti i shkencës dhe teknologjisë INSI SH.P.K., janë fitues të kontratës mbikëqyrja e projekteve të DSHP në Komunën e Prizrenit dhe mendohet që është konflikt interesi”. Lidhur me këtë OE-ja e vetme ofertuese, konkretisht lideri i grupit “P.M.N” Sh.P.K paraqet kërkesë për rishqyrtim të Dokumentin B58, e cila kërkesë është refuzuar si e pabazuar. Tutje lidhur me këtë, OE-ja dërgon lëndën në shkallë të dytë administrative, në OShP. Ankesa e OE-së aprovohet si e bazuar dhe anulon njoftimin mbi vendimin e AK-së dhe aktivitetin e prokurimit e kthen në ri-vlerësim, duke marrë për bazë mendimin e Ekspertit Shqyrtues, i cili thotë se “në asnjë ligj të zbatueshëm në Kosovë për këtë çështje nuk thuhet se është konflikt interesi kur e njëjta kompani e bënë menaxhimin dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të prokurimit”. Pas kthimit në rivlerësim AK-ja me Dokumentin B58 të datës 25.01.2023, prapë OE-në duke e shpallur si të papërgjegjshme dhe kështu duke i gjetur një mori të gabimeve dhe dokumenteve të cilat mungojnë. Konsiderojmë që AK-ja, këtë aktivitet me arsyet e njoftimit të parë do ishte anuluar kundërligjshëm kur e ka përjashtuar për shkak të një kriteri të cilin nuk e ka cekur në njoftimin për kontratë, apo në dosje të tenderit. Pra, në mospërputhje me LPP-në nenin 56, par.3. Kurse konstatojmë që AK-ja në njoftimin e parë mbi vendimin e AK-së është dashur që të shikojë

⁵⁰ Shih aktivitetin e prokurimit: https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2082117

⁵¹ Po aty: https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2304139

me kujdes dokumentet dhe të ofrojë arsytetime të bazuara në ligj, e jo mendime të saj. Rrjedhimisht është dashur që të konsultohet dhe të kërkojë edhe interpretim në KRPP.

9.16. Komuna e Rahovecit

Gjatë vitit 2022, Komuna e Rahovecit ka anuluar gjithsej katër (4) aktivitete të prokurimit, ndërsa aktivitetet e përzgjedhura për monitorim janë aktiviteti me titull “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit LOT 11, 12, 16, 17, 18 dhe 25” me vlerë të parashikuar 56,160.00 euro.⁵² Aktiviteti “Investime në zonën ekonomike në Opterushë – faza e parë”, me vlerë të parashikuar 303,871.75 euro.⁵³

Aktivitetin “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit LOT 11, 12, 16, 17, 18 dhe 25”, komuna e ka anuluar për shkak se Lot 25 ka qenë ofertë e papërgjegjshme, ndërsa për lot 11, 12, 16, 17 dhe 18 nuk ka pranuar asnjë ofertë. Pas monitorimit të INPO-s del që Komuna e Rahovecit me të drejtë i ka anuluar këto lote. Sidoqoftë i tërë ky aktivitet i prokurimit është i kontestueshëm në aspekt ligjor, posaçërisht duke marrë parasysh edhe njoftimin e KRPP-së Nr.06/2021 të datës 02.02.2021, ku kërkohet nga të gjitha AK-të që të mos e përdorin rregullat për shërbime të veçanta për pozita të rregullta të punës.⁵⁴ Pra, rregullat për konsulent mund të aplikohen vetëm për shërbime të cilat nuk mund të merren nëpërmjet procedurave të rregullta rekrutuese sipas Ligjit Nr.08 L-197 për Zyrtarët Publik.

Aktivitetin “Investime në zonën ekonomike në opterushë – faza e parë”, Komuna e Rahovecit e ka anuluar me arsyen se “Komuna e Rahovecit ka pranuar një memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, për financimin e këtij projektit në vlerë prej 1,500,000.00 € investim nga Ministria”.

INPO ka siguruar memorandumun e bashkëpunimit në mes të Komunës së Rahovecit dhe Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe i njëjti është nënshkruar me datë 07.09.2022, i cili parasheh se procedurat e prokurimit për këtë aktivitet i udhëheq vet ministria. Ky anulim i aktivitetit të prokurimit nuk përbën shkelje meqë i njëjti është anuluar konform afateve të papara për anulim para hapjes së tenderëve, rrjedhimisht 6 ditë përpara hapjes së ofertave. Mirëpo, për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, AK-ja nuk ka prodhuar fare dokumentin B58 - Njoftimin mbi Vendimin e AK-së.

9.17. Komuna e Suharekës

Komuna e Suharekës gjatë vitit 2022 ka anuluar në total dhjetë (10) aktivitete të prokurimit. Aktivitetet të përzgjedhura për monitorim janë aktiviteti i parë i anuluar i vitit 2022 “Rregullimi i

⁵² Shih aktivitetin e prokurimit, https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1957273

⁵³ Shih aktivitetin e prokurimit, https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2060955

⁵⁴ Shih njoftimin e KRPP-së, <https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/Documents/Lajmet%20levizese/alb/464/Njoftim%20-%20sherbimet%20e%20veqanta.pdf>.

ambientit për aktivitete kulturore festive - Diafest 2022”.⁵⁵ Aktiviteti i dytë ose i fundit për vitin 2022 “Trajtimi i qenve endacakë”, me vlerë 15,000.00 euro.⁵⁶

Aktiviteti “Rregullimi i ambientit për aktivitete kulturore festive - Diafest 2022” është anuluar pas hapjes së ofertave, ku ka ofertuar vetëm një OE, i cila është shpallur e papërgjegjshme për shkak se ka gabime aritmetike më shumë se dy përqind (2%) e vlerës totale të ofertës..

Aktivitetin “Trajtimi i qenve endacakë” është anuluar në ditën kur parashihej të bëhej hapja e ofertave, konkretisht më datë 07.12.2022 me arsyetimin se “Sipas vendimit të OShP-së nr764-22 të datë 08.03.2023”, paraprakisht kësaj i kishte paraprirë një betejë administrative me të cilin OE-ja “Bujar Mustafa” B.I kishte paraqitur kërkesë për rishqyrtim me të cilin ishte aprovuar ndryshimi i specifikacioneve teknike në DT, me të cilin kishte larguar kriterin kufizues, “Qendra për trajtimin e qenve endacakë duhet të jetë brenda komunës së Suharekës, të dihet adresa e saktë e lokacionit (me fletë poseduese apo kontrat për shfrytëzim të parcelës)”. Aktiviteti para se të anulohet paraprakisht ZPP-ja ishte njoftuar nga drejtori i DBZHRP-së se “kam kërkuar nga ZKF anulimin e zotimit të mjeteve për këtë projekt, me arsyetimin se ky projekt është zgjat shumë në procedura të tenderimit, dhe pasi jemi në fund të vitit dhe kemi rrezikuar që mjetet të shkojnë në suficit. Të njëjtat mjete i kemi alokuar për një projekt tjetër”.⁵⁷ Rrjedhimisht anulimet e tilla në momentin e fundit nuk i sjellin dobi komunës, por vetëm dëm ngase komuna mund të bëhet cak i padive në nivelin gjyqësor, për kompensim të dëmeve të shkaktuar me rastin e përgatitjes së ofertave dhe ndjekjes së procedurave administrative.

9.18. Komuna e Shtimes

Komuna e Shtimes ka të anuluar gjithsej dy (2) aktivitete të prokurimit gjatë vitit 2022. Aktivitetin “Mirëmbajtja e-Kiosk-ës për Komunën e Shtimes”, me vlerë të parashikuar 4,000.00 euro.⁵⁸ Aktiviteti i dytë është “Rregullimi i krojeve dhe burimeve të ujit në Zonat turistike Llanisht, Rancë dhe Karaqicë” me vlerë 5,000.00 euro.⁵⁹

Aktiviteti “Mirëmbajtja e-Kiosk-ës për Komunën e Shtimes”, është anuluar me arsyetimin se “Pasi OE-ja e ka tejkalluar vlerën e parashikuar të kontratës” dhe se “OE-ja nuk i plotëson kriteret për dhënie të kontratës”. Numri i ofertuesve në këtë aktivitet është një (1). dhe INPO poashtu ka gjetur se OE ishte e i papërgjegjshëm në ofertën e tij.

Aktiviteti “Rregullimi i krojeve dhe burimeve të ujit në Zonat turistike Llanisht, Rancë dhe Karaqicë”, kishte vetëm një (1) ofertues dhe si të tillë AK-ja e ka anuluar me arsyetimin se “OE-ja që ka konkuruar në këtë aktivitet të prokurimit, nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit”. Arsyetimi tjetër në Letrat Standarde të Dokumentit B58 është se “në

⁵⁵ Shih aktivitetin e prokurimit: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1989375

⁵⁶ Shih aktivitetin e prokurimit: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2343024

⁵⁷ Shkresa njoftuese për ZPP-në e datës 07.12.2022.

⁵⁸ Shih aktivitetin e prokurimit: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1810022

⁵⁹ Shih aktivitetin e prokurimit: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2214176

certifikatën e regjistrimit tuaj si OE, aktivitet kryesor primar e keni tregtinë me shumicë të drurit”. Ky fakt vërtetohet edhe me deklarin në ARBK-së të OE-së.⁶⁰ Si kriter të tillë që OE-ja duhet të ketë aktivitet primar të ngjashëm me aktivitetin, AK-ja nuk e ka vendosur në Dosje të tenderit apo në B05 - Njoftimin për Kontratë, dhe si të tillë e ka përjashtuar në mënyrë të kundërligjshme, duke u bazuar në ligj, i cili shprehimisht thotë që “Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave të negociuara, pas publikimit të njoftimit të kontratës, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”.⁶¹

9.19. Komuna e Vitisë

Komuna e Vitisë gjatë vitit 2022 ka anuluar pesë (5) aktivitete të prokurimit, ndërsa aktivitetet e përzgjedhura për monitorim janë aktiviteti “Mirëmbajtja e e-kioskut në Pozheran”, me vlerë të parashikuar 4,000.00 euro⁶² dhe aktiviteti “Furnizim me material higjienik për të gjitha njësitë shpenzuese”, me vlerë të parashikuar 21,400.00 euro.⁶³

Aktiviteti “Mirëmbajtja e e-kioskut në Pozheran në Komunën e Vitisë” është anuluar me arsyen se AK-ja nuk ka pranuar asnjë ofertë.⁶⁴ INPO pas monitorimit të ligjshmërisë së anulimit, përkatësisht analizimit të procesverbalit të hapjes së tenderëve gjen se për këtë aktivitet të prokurimit nuk ka ofertuar asnjë OE. Tutje, INPO ka kërkuar nga Komuna e Vitisë qasje në dokumente publike në Njoftimin mbi Vendimin e AK-së, mirëpo nuk ka ofruar qasje dhe INPO ka parashtruar ankësë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi.

Aktivitetin “Furnizim me material higjienik për të gjitha njësitë shpenzuese”, Komuna e Vitisë e ka anuluar me arsyen se për këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pranuar asnjë ofertë të përgjegjshme.⁶⁵ INPO ka siguruar dokumentacionin për këtë aktivitet të prokurimit dhe ka analizuar raportin e vlerësimit për këtë aktivitet të prokurimit. Rezulton se të gjitha ofertat kanë qenë të papërgjegjshme, përfshirë çmime jo-normalisht të ulëta dhe oferta të cilat e tejkalojnë vlerën e parashikuar të aktivitetit të prokurimit.

9.20. Komuna e Vushtrrisë

Komuna e Vushtrrisë ka anuluar gjithsej shtatë (7) aktivitete të prokurimit gjatë vitit 2022. Aktivitetet e monitoruara janë “Furnizim me gas(plin) për nevojat e dy objekteve të institucionit parashkollor Foleja”, me vlerë të parashikuar 1,120.00 euro.⁶⁶ Aktiviteti i shtatë (7) në listë të aktiviteteve të anuluar apo i dyti i monitoruar është “Konkurs projektimi për hartimin e projektit

⁶⁰ Shih më shumë në: <https://arbkrks.gov.net/page.aspx?id=1.38.199460>

⁶¹ Ligji Nr. 04/I-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës Neni 56, par.3 <https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>

⁶² Shih më shumë në: https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1857618

⁶³ Shih më shumë në: https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2235927

⁶⁴ Për më shumë shih aktivitetin e prokurimit https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1857618.

⁶⁵ Shih aktivitetin e prokurimit, https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2235927.

⁶⁶ Shih aktivitetin e prokurimit: https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1890199

“rikonstruimi i bulevardit Adem Jashari dhe lidhja me parkun e qytetit, Vushtrri” me vlerë të parashikuar 55,000.00 euro.⁶⁷

Për aktivitetin “Furnizim me gas(plin) për nevojat e dy objekteve te institucionit parashkollor Foleja”, AK-ja kishte pranuar vetëm një ofertë dhe nga OE-ja “GeoGroup Ing” Sh.P.K. Më 25.05.2022 OE-ja kishte dërguar një shkresë më të cilin thotë që “Sa i përket furnizimit me gas (plin) ka një keqkuptim nga ana jonë pasi kemi menduar se furnizimi me gas bëhet menjëherë e jo sipas porosive javore ose mujore, që do të thotë është e pamundshme realizimi i ofertës nga ana e jonë”. Kësisoj duke u tërhequr nga oferta. AK detyrohet që të anulojë aktivitetin e prokurimit dhe kjo në përputhje me normat ligjore.

Aktiviteti “Konkurs projektimi për hartimin e projektit ‘Rikonstruimi i bulevardit Adem Jashari dhe lidhja me parkun e qytetit’ Vushtrri”, sipas Dokumentin Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për Propozim Teknik të datës 24.01.2023 janë vlerësuar dy (2) ofertues, OE sipas kodit 1303=84.31 dhe 7845=76.64. Dokumenti i radhës B58 i datës 13.03.2023 anulon aktivitetin me arsyetimin se ndër të tjera “janë vërejtur mangësi thelbësore”. E këto vërejtje i ka vënë në pah Drejtorja e Urbanizmit me shkresën e datës 13.03.2023, e cila ndër të tjera thotë se “Drejtorja e Urbanizmit ka vërejtur mangësi thelbësore në Detyrën Projektuese të këtij projekti dhe me qëllim që të mos kemi pengesa në zbatim të këtij projekti pasi që është investim i madh, është shumë më rëndësi të korigjohet detyra dhe të rishpallet ky projekt, andaj kërkohet që tenderi aktual të anulohet, për tu rishpallur përsëri me detyre projektuese më profesionale”. AK-ja e ka anuluar aktivitetin e prokurimit pas hapjes së ofertave në mënyrë të kundërligjshme, sepse me arsyet e cekura ka mundur që aktivitetin e prokurimit ta anulojë para hapjes, mirëpo jo të anulojë aktivitetin pasi që AK-ja ka mësuar së cilët janë OE-të ofertues.

10. Komunat që kanë anuluar aktivitete të prokurimit në mënyrë të kundërligjshme

Nga gjithsej 40 aktivitete të prokurimit të anuluar të moitoruara , INPO ka gjetur se në 6 raste tenderët janë anuluar pa bazë ligjore apo pa arsye të qëndrueshme.

Komunat të cilat kanë anuluar aktivitete të prokurimit në kundërshtim me dispozitat ligjore		
Komuna	Titulli i aktivitetit të anuluar në mënyrë të kundërligjshme	Numri i prokurimit
Dragash	“Furnizimi me material hixhienik për shkollat e Komunës së Dragashit dhe Q.K.M.F. Dragash”	621-22-13769-1-3-6
Ferizaj	“Furnizim me material shpenzues të stomatologjisë për nevojat e QKMF-së”	656-22-290-1-2-1
Glllogoc	“Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i objekteve shëndetësore”	611-22-6570-2-2-1

⁶⁷ Shih aktivitetin e prokurimit: https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2353630

Gjilan	“Asfaltimi, kanalizimi dhe ndriçimi publik në rrugën Nëna Terezë”	651-22-11127-5-1-1
Suharekë	“Trajtimi i qenve endacakë”	624-22-8952-2-2-1
Vushtrri	“Konkurs projektimi për hartimin e projektit ‘Rikonstruimi i bulevardit Adem Jashari dhe lidhja me parkun e qytetit’ Vushtrri”,	644-22-12280-4-2-3

Tabela 7: Komunat të cilat kanë anuluar aktivitete të prokurimit në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Përveq kësaj, INPO ka monitoruar ligjshmërinë e aktiviteteve të anuluar në këto njëzetë (20) komuna edhe gjatë vitit 2021, dhe është e rëndësishme të vlerësohet se cilat komuna edhe në vitin 2022 kanë anuluar tenderë në mënyrë të kundërligjshme dhe cilat kanë shënuar progress. së anulimit të aktiviteteve të prokurimit gjatë vitit 2021 dhe 2022. Kësisoj, në tabelën më poshtë i gjeni të dhënat lidhur me këtë krahasim.

Krahasimi i komunave që kanë pasur aktivitete të anuluar në mënyrë të kundërligjshme gjatë vitit 2021 dhe 2022			
Nr.	Komuna	Aktivitete të anuluar në mënyrë të kundërligjshme gjatë vitit 2021	Aktivitete të anuluar në mënyrë të kundërligjshme gjatë vitit 2022
1	Deçan	Nuk ka aktivitete të anuluar	Nuk ka aktivitete të anuluar
2	Dragash	Jo	Po
3	Ferizaj	Po	Po
4	Glogoc	Po	Po
5	Gjakovë	Jo	Jo
6	Gjilan	Po	Po
7	Kaçanik	Jo	Jo
8	Kamenicë	Jo	Jo
9	Klinë	Jo	Jo
10	Leposaviq	Po	Jo
11	Mitrovicë e Veriut	Po	Jo
12	Pejë	Po	Jo
13	Podujevë	Jo	Jo
14	Prishtinë	Jo	Jo
15	Prizren	Jo	Jo
16	Rahovec	Po	Jo
17	Suharekë	Jo	Po
18	Shtime	Nuk ka aktivitete të anuluar	Jo
19	Viti	Jo	Jo
20	Vushtrri	Po	Po

Tabela 8: Krahasimi i komunave që kanë pasur aktivitete të anuluar në mënyrë të kundërligjshme gjatë vitit 2021 dhe 2022.

Të dhënat në tabelë dëshmojnë se për dallim që gjatë vitit 2021, tetë (8) AK kanë anuluar aktivitetet e prokurimit kundërligjshëm, ky numër gjatë vitit 2022 ka pësuar rënie në gjashtë (6) komuna, të cilat rrjedhimisht kanë anuluar gjashtë (6) aktivitete të prokurimit.

Komunat të cilat kanë anuluar aktivitetet e prokurimit kundërligjshëm, janë pothuajse po ato komuna të cilat të njëjtat i kanë anuluar edhe gjatë vitit 2021. Përjashtuar, Komunen e Suharekës dhe Komunen së Dragashit të cilat gjatë vitit 2021 nuk kanë pasur aktivitetet të anuluar kundërligjshëm, ndërsa gjatë vitit 2022 kanë nga një aktivitet të anuluar kundër dispozitave dhe rregullave për prokurim publik.

I I. Gjetjet kryesore

- Gjatë vitit 2021 komunat kanë anuluar njëqind e tridhjetë e katër (134) aktivitete të prokurimit, dhe vlera totale e aktiviteteve të anuluar është 22,567,215.60 euro apo 16.32% e komplet vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2022 në njëzetë (20) komuna të Republikës së Kosovës.
- Komunat me më së shumti aktivitete të anuluar janë Komuna e Prishtinës me njëzet e tri (23) aktivitete të anuluar, e pasuar nga Komuna e Gjakovës me katërbëdhjetë (14) anulime dhe Komuna e Prizrenit me trembëdhjetë (13) aktivitete të anuluar.
- Komunat me më së paku aktivitete të anuluar gjatë vitit 2022 janë Komunat e Kamenicës, Pejës dhe Shtimes me vetëm nga dy (2) aktivitete të anuluar secila dhe Komuna e Deçanit me asnjë aktivitet të anuluar ashtu sikurse në vitin 2021.
- Gjatë vitit 2022, mesatarisht në çdo komunë përfundimisht janë anuluar shtatë (7) aktivitete të prokurimit.
- Në shumicën e aktiviteteve të prokurimit të anuluar, justifikimi i vendimeve të anulimit është i paqëndrueshëm dhe nuk përkon me situatën reale se pse një AK e caktuar ka anuluar tenderin. Gabimet në hartimin e paramasës, kërkesave të dosjes dhe dokumenteve të tenderit, mungesa e mjeteve financiare, problemet teknike të paargumentueshme në e-prokurim nuk janë asryse të pranueshme dhe të cilat justifikojnë vendimin për anulim. Sidomos kur këto arsye janë përdorur për të anuluar tenderët pas hapjes së tyre.
- INPO ka gjetur se një numër i konsiderueshëm i tenderëve të anuluar, qoftë para hapjes apo pas hapjes së tyre, janë tender që nuk është dashur fare të inicohen ose për shkak të kriterëve apo specifikimeve teknike të cilat kanë qenë me element favorizues apo diskriminues ose për shkak të keqpërdorimit të prokurimit, respektivisht tenderëve përmes së cilëve është tentuar të rekrutohet staf për pozitat e rregullta të administratës publike apo staf mjekësor. Një gjetje dhe respektivisht keqpërdorim i prokurimit, i atribuohet komunave të cilat kanë inicuar tender lënda e së cilave ka qenë e rezervuar për kontrata të centralizuara. Rrjedhimisht, këta tenderë është dashur të anulohen.
- Krahasuar me vitin 2021, komunat gjatë vitit 2022 kanë anuluar gjashtë (6) aktivitete më pak, mirë vlera e anulimeve të aktiviteteve të prokurimi është më e lartë në vitin 2022 për 1,281,339.54 euro.
- Nga njëzetë (20) komunat e monitoruara, pesëmbëdhjetë (15), apo rreth 70% prej tyre, nuk kanë publikuar Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues, për aktivitetet e anuluar, dokument i cili duhet të prodhohet nga AK-ja për çdo aktivitet të anuluar.

- Nga njëqind e tridhjetë e katër (134) aktivitete të anuluar gjatë vitit 2022, njëzetën (21) prej tyre, apo 11.42% janë anuluar para hapjes së ofertave, kurse njëqind e trembëdhjetë (113), apo 88.58%, janë anuluar pas hapjes së ofertave.
- Përveç arsyeve tjera ligjore, ZPP-të deklarojnë se anulimet e aktiviteteve të prokurimit ndodhin edhe për faktin e gabimeve në specifika të tenderit nga njësitë kërkuese.
- Gjatë vitit 2022 dhe i anuluar përfundimisht, në mënyrë të kundërligjshme janë anuluar gjithsej gjashtë (6) aktivitete në gjashtë (6) komuna. Rrjedhimisht, nga një (1) aktivitet në secilën komunë. Një (1) në Komunen e: (i) Dragashit, (ii) Ferizajt, (iii) Glllogoc, (iv) Gjilan, (v) Suharekë, (vii) Vushtrri.

12. Rekomandime

- Komunat të kujdesen që numri i aktiviteteve të anuluar të jetë sa më i vogël, ndërsa atëherë kur anulimi i aktivitetit është i pashmangshëm, të jetë i bazuar në ligj.
- Komunat të kenë parasysh që anulimi i prokurimit duhet të bëhet përmes vendimeve të justifikuara dhe të cilat nuk i atribuohen papërgjegjshmërisë së AK-së gjatë hartimit apo inicimit të tenderit.
- Komunat të mos iniciojnë tenderë që janë të rezervuar për prokurime të centralizuara, kështu kursejnë resurset dhe shmangin parregullësitë gjatë procesit.
- Komunat të mos keqpërdorin procedurat e prokurimit për të rekrutuar staf civil, mjekësor apo tjetër dhe të menaxhojnë burimet njerëzore me transparencë dhe efikasitet.
- Komunat të mos përdorin procedurën e anulimit të tenderëve për të korrigjuar një tender që ka të meta por të sigurohen që përgatitja e tenderëve të jetë sa më efektive dhe efektive ose të përdorin procedurën e përmirësimit apo ndryshimit të të dhënave në dokumentet e tenderit.
- Komuna e Ferizajt, Glllogocit, Gjakovës, Gjilanit, Kaçanikut, Kamenicës, Klinës, Leposaviqit, Pejës, Prishtinës, Prizrenit, Rahovecit, Suharekës, Vitisë dhe Vushtrrisë, të sigurohen që të publikojnë Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues pas çdo anulimi të aktivitetit të prokurimit.
- Komuna e Kaçanikut, Prishtinës, Leposaviqit të sigurohen që të plotësojnë të gjitha informatat e nevojshme në Formularin B10 - Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit.
- Komuna e Glllogocit, Gjakovës, Klinës, Prishtinës, Prizrenit, Vushtrrisë të kujdesen që në Formularin B10 - Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, të vendosin të dhëna të sakta para dhe pas hapjes së ofertave.
- Njësitë kërkuese brenda komunave të sigurohen që të hartojnë specifikat teknike në përputhje me nevojat dhe natyrën e furnizimit, shërbimit apo punës, në të kundërtën anulimi i aktivitetit i bazuar në këto arsye është në kundërshtim me dispozitat ligjore.
- Zyrtarët përgjegjës të prokurimit dhe njësia e kërkesës të kërkojnë ndryshimin e planifikimit të prokurimit bazuar në arsyet e anulimit të aktiviteteve të prokurimit për shkak të ngritjes së çmimeve.

- AK-të të sigurohen që kriteret e paraqitura në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë të jenë në përputhshmëri me natyrën e aktivitetit të inicuar, në mënyrë që aktiviteti të mos anulohet për shkak të mungesës së ofertave.
- Komuna e Dragashit, Ferizajt, Gillogocit, Gjilanit, Suharekës dhe Vushtrrisë të sigurohen që në të ardhmen të mos anulojnë aktivitete të prokurimit në kundërshtim me kërkesat ligjore.
- Komunat t'i adresojnë shkaktarët kryesorë të anulimit të aktiviteteve të prokurimit, posaçërisht në rastet kur mungojnë ofertat dhe rastet kur të gjithë OE-të janë të papërgjegjshëm, në mënyrë që këta shkaktarë të jenë sa më të paktë në të ardhmen.

13. ANEKS I- Lista e aktiviteteve të anuluar në njëzetë (20) komuna

LISTA E AKTIVITETEVE TË ANULUARA NË NJËZETË(20) KOMUNA			
KOMUNA E DEÇANIT			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar ⁶⁸	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1.	Nuk ka aktivitete të anuluar	N/A	N/A
KOMUNA E DRAGASHIT			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1.	Ndërtimi i rezervuarit të ujit rruga Turbe në fshatin Restelicë	621-22-6126-5-2-1	20,280.64
2.	Furnizimi me gjeneratore për shkollat 'Shaban Shabani' - Brezne, 'Sezai Surroi' - Zym, 'Samidin Emiri' - Pllajnik, 'Svetlost' – Krushevë	621-22-13772-1-3-6	3,000.00
3.	Furnizimi me material hixhienik për shkollat e Komunës së Dragashit dhe Q.K.M.F. Dragash	621-22-13769-1-3-6	9,700.00
KOMUNA E FERIZAJT			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1.	Furnizim me material shpenzues të stomatologjisë për nevojat e QKMF-se	656-22-290-1-2-1	66,850.00
2.	Mbushja e bocave me oksigjen medicinal dhe furnizimi me manometra për boca të oksigjenit për nevoja të QKMF-së Ferizaj.	656-22-355-1-3-6	1,500.00
3.	Furnizimi me gjeneratore për nevoja të QMF-1, QMF-5, QMF-6, QMF-7 dhe QMF-8, Ferizaj	656-22-2012-1-2-1	20,000.00
4.	Furnizimi i fermereve me Printer (makina) për vulosje të vezeve	656-22-3638-1-2-1	23,000.00
5.	Mbarsimi artificial i lopëve qumështore dhe mështjerrave, rregullimi dhe mirëmbajtja e thundrrave tek lopët qumështore, vaksinimi i gjedheve dhe bagëtive të imëta kundër sëmundjeve clostridiale	656-22-2298-2-1-1	190,000.00
6.	Furnizim me pajisje mjekësore - LOT IV - Pajisje për Emergjencë	656-22-7968-1-2-1	3,750.00
7.	Bartja e nxënësve LLOT I-Bartja e nxënësve të lagjes Mirash i ri deri të shkollës dhe anasjelltas. LLOT II - Bartja e nxënësve të lagjeve Qarkosh, Lagja e Xhamisë, Miraj, Gerlic, Tafaliaj të Fshatit Komogllave deri të shkollës dhe anasjelltas. LLOT III - Bartja e nxënësve të lagjes Bajram Curri të Fshatit Gaçke deri të shkollës dhe anasjelltas. LLOT IV - Bartja e nxënësve të lagjes Ugzmajli të Fshatit Jezerc deri të shkollës dhe anasjelltas	656-22-8464-2-2-1	39,000.00
8.	Funksionalizimi i deponive të ngurta	656-22-1013-5-2-1	120,000.00
9.	Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informativë	656-22-13923-5-5-8	35,000.00
10.	Furnizimi i fermerëve me koshere të bletëve	656-22-1926-1-2-1	40,000.00
KOMUNA E GLOGOCIT			

⁶⁸ **Sqarim:** Titujt e aktiviteteve janë në formën origjinale si janë publikuar nga komunat me apo pa gabime drejtshkrimore.

Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1.	Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i objekteve shendetësore	611-22-6570-2-2-1	15,000.00
2.	Rregullimi dhe mirembajtja e trotuareve dhe parkingjeve - faza e dyte	611-22-9732-5-3-6	4,074.00
3.	Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative	611-22-8012-5-5-8	35,994.00
4.	Furnizim me veshmbathje per nevojat e puntoreve te komunes	611-22-12284-1-3-6	7,905.00
5.	Sigurime aksidentale per nxenesit ne shmp Fehmi Lladrovci Drenas	611-22-12776-2-2-1	35,857.57
6.	Marrëveshje kornizë Furnizim me pemë dhe perime	611-22-13293-5-5-8	12,643.00
7.	Ndërtimi i kapaciteti të ujësjellsit - Projekt dy vjeçar	611-22-12335-5-2-1	300,000.00
KOMUNA E GJAKOVËS			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1.	Transporti i nxënësve në relacione të ndryshme - Llot III - Transporti i nxënësve në relacionin Smaq I Bishtazhin dhe anasjelltas	632-22-1037-2-2-1	2,430.00
2.	Furnizimi, montimi dhe ndërtimi me material për klasën verore në SHFMU "Ukshin Miftari"	632-22-3675-1-3-6	2,984.40
3.	Furnizim me lule dhe kurora	632-22-4629-1-2-1	16,000.00
4.	Inspektimi i kërkesave themelore për shëndet dhe siguri për ndërtimet pa leje-për ndërtimet në kategorinë II-të(jo shtëpitë)	632-22-6221-2-2-1	40,000.00
5.	Ndërtimi i stadionit të qytetit në Gjakovë - Kontratë dy vjeçare	632-22-5416-5-1-1	1,500,000.00
6.	Akordimi i veglave muzikore në shkollën Prenk Jakova	632-22-10811-2-3-6	2,000.00
7.	Ndërtimi i shesheve dhe rreth rrotullimeve në qytet	632-22-7732-5-2-1	29,989.33
8.	Furnizim me material shpenzues për laborator dhe kabinete - LOT IV - Furnizim me material për kabinetin e makinerisëPovratak na vrh	632-22-10129-1-3-6	2.112,28€
9.	Furnizimi me material për serra dhe mirëmbajtja e serrave	632-22-12455-1-3-6	3,497.00
10.	Ndërtimi i parkut të qytetit	632-22-11676-5-2-1	140,403.74
11.	Sistemi për menaxhimin elektronik të automjeteve GPS	632-22-12338-2-2-1	11,760.00
12.	Shërbime të telefonisë mobile-Kontratë tre vjeçare	632-22-2113-2-2-1	60,000.00
13.	Furnizimi me aparate mjekësore dhe jo mjekësore	632-22-6415-1-2-1	60,000.00
14.	Rregullimi i shtratit të Lumit Krena	632-22-7920-5-1-1	656,741.41
KOMUNA E GJILANIT			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1.	Shërbime Konsulente te Individuale per nevoja te Komunes se Gjilanit	651-22-27111-2-1-1	211,116.00
2.	Rregullimi i dyshemesë të sallës shk. Zenel Hajdini	651-22-3141-5-2-1	13,800.00
3.	Furnizim me Makine për larjen e rrobave	651-22-3353-1-2-1	13,800.00
4.	Mirëmbajtja e E-Kioskave ne Komunën e Gjilanit	651-22-12544-2-3-6	3,800.00
5.	Furnizim me material higjenik	651-22-11583-1-2-1	106,623.00
6.	Transporti i nxënësve në relacion Muqibabë - Gjilan SH.F.M.U Zija Shemsiu dhe anasjelltas.	651-22-12722-2-3-6	6,500.00
7.	"Pastrimi i rrugëve, trotuareve, mirëmbajtja e parqeve dhe hapsirave gjeberuese	651-22-9140-2-2-1	80,000.00
8.	Asfaltimi i rrugëve lidhëse me rrugën Qarkore	651-22-5238-5-2-1	208,902.00

9.	Asfaltimi, kanalizimi dhe ndriçimi publik në rrugën Nëna Terezë	651-22-11127-5-1-1	512,625.00
KOMUNA E KAÇANIKUT			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1.	Sherbime kontraktuale-Specialist i Gjinekologjisë	652-22-5100-2-2-1	14,400.00
2.	Ndërtimi i rrjeteve të ujësjellësve- faza e parë	652-22-2182-5-3-6	9,950.00
3.	Rregullimi dhe asfaltimi i rrugës që lidhë vendbanimet Gërllicë- Kaçanik i vjetër- Stagovë-Runjevë, segmenti Stagovë – Runjevë	652-22-6304-5-2-1	291,300.00
4.	Mirëmbajtja e ndriçimit publik	652-22-11622-2-2-1	50,000.00
KOMUNA E KAMENICËS			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1.	Marrëveshje kornizë Furnizim me pemë dhe perime	KM653-22-11191-5-5-8	3,399.00
2.	Furnizim me kamera dhe pajisje tjera për teknologji informative	KM653-22-11997-1-3-6	9,370.00
KOMUNA E KLINËS			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1.	Furnizim me shujta ditore per nxenes	634-22-369-1-2-1	93,264.00
2.	Sherbime te telefonise mobile per nevoja te administrates komunale	634-22-76-2-2-4	36,000.00
3.	Furnizim me oksigjen O2 per nevoja te QKMF-se Nene Tereza Kline	634-22-940-1-3-6	4,000.00
4.	Mbeshtetje e komunes ne pergaditje te pzhk per vitet 2023-2031	634-22-6616-3-2-2	40,000.00
5.	Furnizim me materjal per praktike profesionale	634-22-8126-1-2-1	26,000.00
6.	Hartim i projekteve zbatuese	634-22-79-2-2-1	40,000.00
7.	Furnizim me materjal ndertimor Projekt per kumonitete	634-22-11065-5-2-1	30,000.00
8.	Ndertim i stacionit te autobusave faza II	634-22-13727-5-2-1	90,000.00
KOMUNA E LEPOSAVIQIT			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1.	Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave të komunës së Leposaviqit	641-22-4353-2-2-1	20,000.00
2.	Creation of project-technical documentation	641-22-11901-2-2-1	40,000.00
3.	Procurement of sports equipment and props	641-22-11777-1-2-1	12,000.00
4.	Shërbimet e organizimit të festivalit rock	641-22-12068-2-3-6	9,995.00
5.	Prokurimi i mobiljeve	641-22-11039-1-2-1	12,000.00
KOMUNA E MITROVICËS SË VERIUT			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1.	Shërbimet e prokurimit dhe instalimit të barrierave automatike të parkimit përgjatë trotuarit në rrugën Kralja Petra I në Mitrovicën Veriore	647-22-12629-2-3-6	2,000.00
KOMUNA E PEJËS			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1.	Blerja e një autokombi për QKMF-në	635-22-971-1-2-1	30,000.00
2.	Mirëmbajtja verore e rrugëve në Rugovë	635-22-8396-2-1-1	90,000.00
KOMUNA E PODUJEVËS			

Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1.	Furnizim me shoqëri bletësh dhe koshere	615-22-2550-1-2-1	65,000.00
2.	Servisimi i automjeteve të institucioneve komunale	615-22-7089-2-2-1	30,000.00
3.	Përmirësimi i infrastrukturës së jashtme dhe të brendshme të shkollave - LOT IV - Gëlqerosja e shkollave	615-22-2987-5-2-1	40,000.00
4.	Podujeva për efikasitet dhe zhvillim efikas	615-22-9033-5-2-1	170,944.40
KOMUNA E PRISHTINËS			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1.	Furnizim me material shpenzues administrativ për nevojat e Komunës së Prishtinës	616-22-3601-1-2-1	100,000.00
2.	Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative	616-22-1338-5-5-8	32,000.00
3.	Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor	616-22-5534-2-1-1	450,000.00
4.	Furnizim me uniforma	616-22-6323-1-2-1	50,000.00
5.	Furnizim me pajisje kabinetike	616-22-5688-1-2-1	120,000.00
6.	Vendosja e kamerave të sigurisë	616-22-7459-1-1-1	300,000.00
7.	Furnizimi me pajisje për trajtimin, ambalazhimin dhe deponimin e mbetjeve të asbestit	616-22-8409-1-3-6	6,500.00
8.	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal - LOT IV	616-22-2845-2-1-1	300,000.00
9.	Furnizimi me gardërobe dhe mbathje për institucionet parashkollore	616-22-9931-1-3-6	9,000.00
10.	Furnizimi me pajisje kabinetike për shkollën Dr. Ali Sokoli - LOT II.	616-22-9574-1-2-1	2,500.00
11.	Furnizim me tabela të menqura për institucionet arsimore	616-22-8816-1-1-1	400,000.00
12.	Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të QKMF-se dhe QMU-se	616-22-3585-2-1-1	150,000.00
13.	Shërbime për konsulence për angazhimin e 10 ekspeteve për projekte profesionale - LOT I, II, III, IV, V, VI, VII.	616-22-6983-2-1-1	140,000.00
14.	Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave në objektin e Komunës dhe institucioneve tjera Komunale	616-22-1994-1-2-1	80,000.00
15.	Ndërtimi i Therrëtores Publike për Kafshë në Komunë të Prishtinës	616-22-14398-5-2-1	400,000.00
16.	Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve për zonat rurale - LOT 26	616-22-13354-2-1-1	21,500.00
17.	Rikonstruimi dhe ndërtimi i rrugëve në Prishtinë - Ritender - LOT II	616-22-11288-5-1-1	226,070.40
18.	Konkurs projektimi dhe ndërtimi sipas sistemit çelës në dorë të godinës Tulltores (Fabrika e Tullave) për Sallën Multifunkcionale të Koncerteve.	616-22-12588-5-1-2	1,300,000.00
19.	Rregullimi i varrezave të deshmorëve në Viti të Marecit - Prishtinë - ritender	616-22-11323-5-1-1	550,000.00
20.	Instalimi dhe mirëmbajtja e elektrikës në Institucionet Arsimore - LOT II.	616-22-10299-2-2-1	20,000.00
21.	Vazhdimi i punimeve në shkollën fillore Nëna Terezë	616-22-13807-5-2-1	350,000.00
22.	Furnizimi dhe rregullimi i vendeve të kontinjereve	616-22-8560-1-1-1	600,000.00
23.	Master plani për rigjenerimin e lagjes Kolovica	616-22-10260-2-1-1	400,000.00
KOMUNA E PRIZRENIT			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1.	Furnizim me libra sanitare për stafin e kujdesit parësor në Komunën e Prizrenit	622-22-8485-1-2-1	12,000.00

2.	Sigurimi i zërimit dhe ndriqimit për aktivitetet e drejtorisë për Kulturë, Rini, dhe Sport	622-22-3455-2-3-6	9,800.00
3.	Ofrimi i shërbimeve konsulente nëpërmjet marrveshjeve për shërbime të veqanta (konsulent individë) për nevojat e njësisë së auditimit të brendshëm në Komunën e Prizrenit 2 LOTE PJESE	622-22-9819-2-3-6	5,700.00
4.	Mirëmbajtja dhe riparimi i paisjeve teknike në objektet e shëndetësisë primare në Komunën e Prizrenit	622-22-10820-2-2-1	30,000.00
5.	Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative kompjutera statik për shkollën e mjeksisë Luciano Motroni në Prizren	622-22-12012-5-5-8	9,550.00
6.	Furnizim me tabela digjitale për shkollat e Komunës së Prizrenit	622-22-10266-1-2-1	50,000.00
7.	Furnizim me paisje laboratorike për nevojat e shërbimeve shëndetësore në kujdesin primar	622-22-12099-1-2-1	30,000.00
8.	Furnizim me gjenerator për nevojat e institucioneve arsimore në Prizren	622-22-12953-1-2-1	20,000.00
9.	Ndërtimi i qendrës kulturore rinore Turke në Prizren	622-22-10628-5-1-1	1,550,000.00
10.	Ndërtimi i objektit të ri shkollorë në fshatin Mazrrek hasit të Prizrenit	622-22-10577-5-1-1	900,000.00
11.	Renovimi i tërësisëm i sallës së edukatës fizike, të shkollës Emin Duraku në Prizren	622-22-12945-5-2-1	100,000.00
12.	Vendosja dhe mirëmbajtja e kamerave të sigurisë në Qytetin e Prizrenit	622-22-7502-2-1-1	770,000.00
13.	Menaxhimi i projekteve të Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Prizrenit	622-22-7388-2-1-1	150,000.00

KOMUNA E RAHOVECIT

Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1.	Shërbime konsulente individuale për nevojat e komunës së rahovecit	623-22-5173-2-1-1	56,160.00
2.	Furnizim me material shpenzues mjekësor për nevojat e QKMF- së - LOT IV - Furnizim me oksigjen	623-22-3932-1-2-1	1,112.32 €
3.	Bartja e nxënësve në relacionet për vitin shkollor 2022 2023 - LOT VIII - Bartja e nxënësve në relacionin Vrajak, Bratotin – Ratkoc dhe anasjelltas për vitin shkollor 2022 2023	623-22-7552-2-2-1	5,337.00
4.	Investime në zonën ekonomike në opterushë – faza e parë	623-22-8641-5-2-1	303,871.75

KOMUNA E SUHAREKËS

Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1.	Rregullimi i ambientit për aktivitete kulturore festive - Diafest 2022	624-22-6908-2-3-6	9,950.00
2.	Ndërtimi dhe rregullimi Kolektorit në rrugën Skenderbeu – Suharekë	624-22-5350-5-1-1	870,000.00
3.	Mirëmbajtja e e-kioskave	624-22-10862-2-3-6	3,000.00
4.	Projektet me bashkëfinancim-Ndërtimi i shtëpisë së kulturës Ukë Bytyq i -faza e dytë	624-22-11311-5-1-1	3,100,000.00
5.	Ndërtim i rrugëve “Regjep Velia - me segment, Molika , Shaljanet -segment, Kovaqi , Tafa , Jetush Shala , Haxhi Shania etj.në Mushtisht ,faza e dytë	624-22-12098-5-2-1	22,786.83
6.	Furnizimi -mirëmbajtja e paisjeve të shkollave të ngrohjes qendrore për vitin shkollor 2022 23	624-22-12171-1-2-1	40,000.00
7.	Shërbimet e Energjisë sipas Udhëzimit Administrativ Shërbimet e Energjisë (ESCO)	624-22-12988-2-1-1	2,066,342.20
8.	Furnizim me mjete konkretizimi -Paisje me kabinete	624-22-7317-1-2-1	30,008.80

9.	Shërbimet e transportit të nxënësve për vitin 2023-2024 7 lot, LOT I, II, IV, VI.	624-22-14617-2-1-1	70,960.56
10.	Trajtimi i qenve endacak	624-22-8952-2-2-1	15,000.00
KOMUNA E SHTIMES			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1.	Mirëmbajtja e-Kiosk-ës për Komunën e Shtimë	617-22-2520-2-3-6	4,000.00
2.	Rregullimi i krojeve dhe burimeve të ujit në Zonat turistike Llanisht, Rancë dhe Karaqicë	617-22-12364-5-3-6	5,000.00
KOMUNA E VITISË			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1.	Mirëmbajtja e e-kioskut në Pozheran	657-22-3508-2-3-6	4,000.00
2.	Furnizimi me farë misri për nevojat e fermerëve	657-22-1035-1-2-1	32,000.00
3.	Furnizim me fidane të arrës Chandler , dhe rezervuarë për sistemin e ujitjes	657-22-995-1-2-1	14,426.25
4.	Hartimi i projekteve investive(kapitale) për komunën e Vitisë	657-22-4587-2-1-1	300,000.00
5.	Furnizim me material higjienik për të gjitha njësit shpenzuese	657-22-11371-1-2-1	21,400.00
KOMUNA E VUSHTRRIË			
Nr.	Titulli i aktivitetit të anuluar	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar €
1.	Furnizim me gas(plin) për nevojat e dy objekteve të institucionit parashkollor Foleja	644-22-4409-1-3-6	1,120.00
2.	Furnizim me pajisje për lavaxtë	644-22-6272-1-3-6	6,000.00
3.	Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni rr "Skenderbeu,, Bekim Zenuni dhe „Mursel Hyseni"	644-22-8086-5-2-1	206,116.40
4.	Furnizim me vetura zyrtare sipas Lot1 dhe lot2	644-22-12195-1-2-1	85,000.00
5.	Dekorimi i qytetit për festat e fund vitit	644-22-13658-2-3-6	9,945.00
6.	Shtypja e materialeve të ndryshme zyrtare.	644-22-12826-2-2-1	25,980.00
7.	Konkurs projektimi për hartimin e projektit "rikonstruimi i bulevardit Adem Jashari dhe lidhja me parkun e qytetit ", Vushtrri	644-22-12280-4-2-3	55,000.00

Iniciativa për Progres (INPO) është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e themeluar në vitin 2005 me qëllim që të përparoj pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset shoqërore, përmes së cilës pjesëmarrje avokohet për çështjet sociale, politike, ekonomike, forcimin e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike, rritjen e kërkesave të qytetarëve si dhe luftimin e korrupsionit, duke synuar në promovimin e vlerave të një shoqërie të hapur dhe demokratike.

Vizioni dhe misioni i organizatës përmbushet përmes aktiviteteve të ndryshme të punës të cilat organizohen nga dy (2) programet e specializuara të organizatës: 1. Qeverisja e Mirë dhe Edukimi Demokratik.